



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

¹Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës datë 08.02.2018, për dorëheqje nga funksioni, të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Merita Xhani.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|------------------------------|------------------|
| 1. Ilir Meta | (kryetar) |
| 2. Xhezair Zaganjori | (anëtar) |
| 3. Gjini Gjoni | (anëtar) |
| 4. Astrit Haxhialushi | (anëtar) |
| 5. Vangjel Kosta | (anëtar) |
| 6. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 7. Petrit Çomo | (anëtare) |

¹ Kjo mbledhje hapet me trajtimin e pikës 6 e pikat e tjera vijuese për shkak të mosqenies prezent të ministres së Drejtësisë, për të vazhduar me trajtimin e procedimeve në momentin e ardhjes në sallë të zonjës Gjonaj.

- | | |
|-------------------------|-----------------|
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Neritan Cena</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.*
- 12. Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i kërkesës datë 08.02.2018, për dorëheqje nga funksioni, të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Merita Xhani.

Ilir Meta: Fillojmë atëherë?

Meqenëse kemi problem për sa i takon pjesëmarrjes, meqenëse ministrja do vijë pak me vonesë, mendoj të kalojmë tek pika e gjashtë. Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga funksioni të gjyqtarës...

Po! Kishit gjë?

Gjin Gjoni: Zoti President, ne e pamë këtë rendin e ditës.

Mendoj që, në qoftë se ju e gjykoni dhe Këshilli merr vendimmarrje edhe në lidhje me këtë Pajtime Fetahu që të futet në rend dite, meqenëse ka një vendim gjyqësor në lidhje me këtë dhe ka rënë shkak i pezullimit. Faleminderit!

Ilir Meta: Po, Gerdi!

Gerd Hoxha: Edhe unë i këtij mendimi jam. Madje ne jemi të detyruar, e kemi detyrim edhe nga ligji sepse dy herë, kemi qenë 5 anëtarë që kemi nënshkruar për futjen në rendin e ditës dhe herën e kaluar, në mbledhjen e kaluar u tha që të futet në mbledhjen e ardhshme, kështu që e kemi në vijim të diskutimit të ardhshëm. Të futet në rend dite dhe të procedojmë.

Ilir Meta: Procedura, si është?

Procedura për të futur në rendin e ditës?

Po, Profesor!

Xhezair Zaganjori: A i kemi materialet për të gjykuar? I kemi materialet?

Nëse i kemi materialet, atëherë mund të futet.

Gerd Hoxha: Materialet kanë qenë aty që në mbledhjen e kaluar.

Ilir Meta: Janë materialet aty Pjerin?

Ridvan Hado: Materialet kanë kohë. Janë thënë edhe në seancën e kaluar nga ju u kërkua që të futet në rendin e ditës. Materialet janë depozituar me kohë, plus 5 anëtarë, në referim të nenit 20 të ligjit "Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e kanë kërkuar me kohë këtë fakt.

Ilir Meta: Dakord atëherë! Meqenëse është kërkuar nga 5 anëtarë në mënyrë të përsëritur, le të përfshihet në fund të rendit të ditës.

Astrit Haxhialushi: Me leje?

Ilir Meta: Po!

Astrit Haxhialushi: Faleminderit, zoti President!

Duke marrë shkas edhe nga pika 9 “Shqyrtimi i raportit mbi organikat e paplotësuara të gjykatës dhe mundësinë e transferimit të përkohshëm” edhe nga propozimi që kanë bërë 5 gjyqtarët, duke qenë edhe unë një nga ato firmëtarët për Pajtime Fetahun, njëkohësisht i propozoj mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të marri në shqyrtim edhe kërkesën e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, Osman Aliu, i cili ka vendim penal të formës së prerë për pafajësi edhe në Gjykatën e Lartë dhe duke marrë në konsideratë këtë propozim e bëj jo vetëm për detyrimin dhe obligimin që ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë i cili në disa mbledhje të mëparshme kishte vendosur pezullimin por edhe për shkak të volumit të punës që po përballojnë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë. Dhe duke marrë edhe në konsideratë nga ai raport që ka paraqitur Kryeinspektorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe propozimi i ministres së Drejtësisë për Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë.

Petrit Çomo: Kemi marrë vesh që magjistratët që nuk janë emëruar i kanë bërë një letër Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim edhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse letra është e vërtetë që ka ardhur, ndoshta duhet ta shqyrtojmë këtë.

Ilir Meta: Po! Pjerin!

(Zoti Prendi përgjigjet pa ndezur mikrofonin.)

Pjerin Prendi: Ka ardhur një shkresë nga magjistratët. Po shqyrtohet nga administrata. Do i bëhet me dije anëtarëve të Këshillit.

Ilir Meta: Dakord!

Gerd Hoxha: Një pyetje! Ajo shkresë kujt i është drejtuar, administratës apo Këshillit? Në qoftë se i është drejtuar Këshillit, nuk i takon administratës. Do na vihet ne këtu dhe ne do marrim vendim se çfarë do bëjmë.

Pjerin Prendi: I është drejtuar Kryetari të Këshillit së pari.

Gerd Hoxha: Okej!

Unë jam i këtij mendimi, çdo kërkesë që i vjen Këshillit, sepse ne jemi përditë me kolegët, qofshin ata me kërkesa të gabuara apo me kërkesa të drejta, ne jemi të detyruar të kthejmë përgjigje. Por do t’i kthejmë ne përgjigje, jo ju.

Unë ju falenderoj shumë. Ju keni një punë shumë të madhe dhe shumë ngarkesë, por ato gjëra që na takojnë ne duhet të na vijnë edhe ne pastaj të vendosim se çfarë do bëhet. Faleminderit!

Ilir Meta: Dakord!

Kujt i është drejtuar ajo Pjerin?

Pjerin Prendi: Kryetarit të Këshillit dhe anëtarëve besoj.

Ilir Meta: Në qoftë se i është bërë edhe anëtarëve, bëjini një kopje edhe anëtarëve ta shikojnë. Ta shikoj edhe unë se s'e kam parë.

Dakord! Për atë kërkesën për gjyqtarin e Kavajës, për mbledhjen tjetër. Se duhen bërë edhe materialet gati. Atëherë, vazhdojmë. Me pikën 6. Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga funksioni, të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Merita Xhani.

Jemi dakord me këtë gjë?

Dakord!

Aprovohet!

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga funksioni, të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Brunilda Kasmi.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Xhezair Zaganjori</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.*
- 12. Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga funksioni, të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Brunilda Kasmi.

Ilir Meta: Pika 7. Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga funksioni i gjyqtares së Gjykatës Tiranë, Brunilda Kasmi.

Jemi dakord?

Jemi dakord.

Miratohet!

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit më 10.04.2018 të gjyqtares Nazmie Pengili.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Xhezair Zaganjori</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci, znj. Eneida Civici.**

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
2. **Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
4. **Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
6. **Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
7. **Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.**
8. **Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.**
9. **Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.**
10. **Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
11. **Eksperte e Misionit EURALIUS.**
12. **Ekspert i USAID-it.**

RENDI I DITËS:

8. Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit më 10.04.2018 të gjyqtarës Nazmie Pengili.

Ilir Meta: Deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të gjyqtarës Nazmie Pengili.

Jemi dakord?

Dakord!

Miratohet!

(Zoti Cena flet pa ndezur mikrofonin.)

Neritan Cena: Unë jam kundër.

Ilir Meta: Me shumicë miratohet. Dakord!

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm si dhe propozimeve përkatëse për plotësimin e vendeve vakant.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** (kryetar)
2. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
3. ***Astrit Haxhialushi*** (anëtar)
4. ***Vangjel Kosta*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Petrit Çomo*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Gerd Hoxha*** (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Z. Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i Raportit “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm si dhe propozimeve përkatëse për plotësimin e vendeve vakant.

Ilir Meta: Shqyrtimi i Raportit “Mbi organikat e paplotësuara të gjykatave dhe mundësitë e transferimit të përkohshëm si dhe propozimeve përkatëse për plotësimin e vendeve vakant. Keni raportin e grupit të punës për të propozuar zgjidhjet brenda kuadrit

ligjor për transferimin e përkohshëm në një periudhë kohe të gjyqtarëve në ato gjykata ku ka kërkesa mbas studimit të bërë.

Po!

Marsida Xhaferllari: Faleminderit!

Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 18 janar 2018, me kërkesë të ministres së Drejtësisë, Këshilli i Lartë vendosi të realizohet një pasqyrim statistikor mbi numrin e gjyqtarëve faktik në çdo gjykatë, të kryhen përllogaritjet e ngarkesës mesatare të gjyqtarëve sipas gjykatave dhe bazuar në gjetjet e këtyre pasqyrimeve statistikore, të vijohet me ndjekjen e procedurave ligjore për të kryer transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve. Për këtë qëllim, grupi i punës i ngritur, në përbërje, qoftë nga Inspektorati, në bashkëpunim edhe me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, ka hartuar raportin që ju është shpërndarë, raport me shkrim. Është analizuar situata aktuale. Janë marrë të dhëna statistikore në të gjitha gjykatat e shkallës së parë. Është analizuar kuadri ligjor i zbatueshëm, konkretisht ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, i cili lejon transferimin e përkohshëm të gjyqtarit.

Kuadri ligjor është implementuar më pas në situatën aktuale dhe janë nxjerrë disa konkluzione në përfundim të këtij raporti dhe konkretisht:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë situata dikton që të procedohet me transferimin e përkohshëm e të paktën 1 gjyqtari për një periudhë 6 muaj deri në 1 vit. Mundësitë e transferimit janë si më poshtë: Së pari, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pranë të cilës ushtrojnë detyrën 16 gjyqtarë, me 1 gjyqtar më pas nga organika e miratuar prej 17 gjyqtarësh. Më duhet të theksoj këtu që këto të dhëna i referohen kohës së hartimit të këtij raporti, pra fundit të marsit të vitit 2018. Asnjë gjyqtar nuk ka dhënë pëlqimin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për t’u transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pranë së cilës ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë, me 1 gjyqtar më pak nga organika e miratuar prej 14 gjyqtarësh, në këtë gjykatë ka dhënë pëlqimin për transferim gjyqtarja Igerta Hysi; Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, pranë së cilës ushtrojnë detyrën 3 gjyqtarë, me 1 gjyqtar më pak nga organika e miratuar prej 4 gjyqtarësh, në këtë gjykatë kanë dhënë pëlqimin për transferim gjyqtarja Rezarta Aliu dhe gjyqtari Dritan Hasani. Kryetari i

gjykatës ka dhënë mendim pozitiv për transferimin e përkohshëm të një prej këtyre dy gjyqtarëve.

Çështja e dytë është për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, ku situata dikton që të procedohet me transferimin e përkohshëm e të paktën 1 gjyqtari, për një periudhë 6 muaj ose 1 vit, në vlerësim të KLD-së. Mundësitë e transferimit janë si më poshtë: Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pra së cilës ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë, me 1 gjyqtar më pak nga organika e miratuar prej 14 gjyqtarësh. Asnjë gjyqtar nuk ka dhënë pëlqimin për t'u transferuar në mënyrë të përkohshme nga kjo gjykatë. Edhe kryetari i gjykatës ka dhënë mendim negativ për transferim të përkohshëm nga kjo gjykatë; Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, pranë së cilës ushtrojnë detyrën 4 gjyqtarë, pa asnjë vend vakant, në këtë gjykatë ka dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm gjyqtari Rexhep Karaj. Kryetari i gjykatës është shprehur pozitivisht për këtë transferim të përkohshëm; Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, pranë së cilës ushtrojnë detyrën 3 gjyqtarë, me 1 gjyqtar më pak nga organika e miratuar prej 4 gjyqtarësh, në këtë gjykatë ka dhënë pëlqimin gjyqtari Erjon Çela. Kryetari i gjykatës është shprehur pozitivisht për këtë transferim të përkohshëm.

Së treti, lidhur me situatën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, vlerësohet të procedohet duke deleguar gjyqtarë për një grup çështjesh gjyqësore.

E njëjta situatë edhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe për Gjykatën Administrative të Apelit. Faleminderit!

Ilir Meta: Zoti Gjoni, po!

Gjin Gjoni: Faleminderit, zoti President!

U njohëm me materialin e paraqitur nga Kryeinspektorja, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë.

Në lidhje me këtë material unë jam plotësisht dakord por do shtoja edhe në lidhje me disa gjykata të cilat janë problematike. Përveç Kavajës, Krujës dhe Lezhës dhe Kukësit është Gjykata e Shkallës së Parë Administrative në Shkodër e cila aktualisht është me 2 gjyqtarë dhe njëri prej tyre është me procedim dhe me masë disiplinore dhe në

rast se ky Këshill i Lartë i Drejtësisë do vendosë, mbetet me një gjyqtar. Është edhe Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Durrës, e cila aktualisht është një nga gjykatat, pas Gjykatës së Tiranës, me ngarkesë më të madhe dhe ka vetëm 3 gjyqtarë në përbërjen e saj dhe Gjykata e Shkallës së Parë Administrative mund të jetë një variant.

Çështja e fundit, e tretë, është në lidhje me Gjykatën e Apelit Administrativ, e cila ka bërë disa kërkesa në lidhje me komandimet e gjyqtarëve. Meqenëse çështjet në Gjykatën e Apelit Administrativ janë çështje të cilat po gjykohen të vitit 2014 dhe ne jemi në vitin 2018 dhe për shkak të ndryshimeve dhe të futjes në fuqi të kësaj gjykate, i gjithë sensi i krijimit të kësaj gjykate edhe nga organet shqiptare por edhe nga faktori ndërkombëtar, ishte për të gjykuar në një kohë rekord këto gjykime. Çështje administrative që presin për 4 vjet, mua më duket pak nonsens për vetë faktin për të cilën është krijuar kjo gjykatë.

Ilir Meta: Dakord!

Gjin Gjoni: Faleminderit!

Ilir Meta: Unë kam përshtypjen që në mbledhjen e sotme do të shqyrtojmë këto 5 rastet e këtyre gjykatave që ka sjellë...

Marsida Xhaferllari: Përfshihen edhe këto që thotë...

Ilir Meta: Përfshihen edhe këto?!

Gjin Gjoni: Dhe e dyta, -më fal, zoti President!

Po t'i referohesh ligjit, duhet patjetër që të shpallen këto gjykata dhe pastaj të bëhen publike, -thotë ligji, dhe pas bërjes publike, të vijnë kërkesat dhe mbi bazën e kërkesave ne duhet të vendosim.

Me mbledhjen e sotme të përcaktohet numri i gjykatave të cilat do shpallen dhe numri i personave ose i vendeve vakante për secilën gjykatë që ne pretendojmë që mund të plotësojmë, dhe pas saj te bien kërkesat dhe mbi bazën e kërkesave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë të vendosë përfundimisht në caktimin e tyre.

Ilir Meta: Atëherë, mendim tjetër?

Marsida Xhaferllari: Më falni! Lidhur me këtë çështje, deri më sot, praktika që ka ndjekur Këshilli i Lartë i Drejtësisë për gjykatat administrative ka qenë që janë marrë gjyqtarë nga gjykatat ku këto kanë selinë, pra për Gjykatën Administrative të Shkodrës

janë marrë gjyqtarë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe janë çuar për një grup çështjesh, për shembull për të gjykuar 50 çështje të kësaj gjykate. Në qoftë se ju do merrni vendim që të bëhet procedura e transferimit të përkohshëm me anë të kërkesave të gjyqtarëve që japin pëlqimin apo sipas gjykatave që kanë nevojë, kjo sigurisht pastaj që është në vendimmarrjen tuaj dhe do një analizë më të detajuar.

Ilir Meta: Po, Gerdi!

Vetëm, t'i japim zgjidhje.

Gerd Hoxha: Po, t'i japim zgjidhje.

Atëherë, që të respektojmë ligjin ku jemi, së pari doja të theksoja edhe një herë kompetencën që ka ky Këshill i Lartë i Drejtësisë bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të bërë të gjithë emërimet e mundshme. Të paktën unë kështu e lexoj atë paragrafin e Gjykatës Kushtetuese që e kam cituar këtu disa herë.

Në rastin konkret ndodhemi përpara një emergjence, por kjo nuk na shtyn që ne të mos respektojmë siç duhet ligjin. Duhet të respektojmë patjetër parashikimin e nenit 46 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve", ku ka të bëjë me transferimin e përkohshëm. Nuk kemi pse të fokusohemi në disa emra të caktuar. Ne duhet të bëjmë, të plotësojmë procedurën. Duhet që të lançojmë këtë thirrje dhe t'u themi gjyqtarëve të japin pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht në gjykatat që kanë probleme, dhe nuk janë vetëm këto gjykata por ka edhe gjykata të tjera. Mbasi ata të japin pëlqimin, do t'u kërkojmë pëlqimin kryetarëve të gjykatave për këta gjyqtarë dhe pastaj mund të procedojmë me plotësimin e vendeve në këto gjykata. Kështu që... E kemi të detyruar këtë.

Ne mund të bëjmë transferim me zor, domethënë pa pëlqim, vetëm në rastet kur nuk ka. Ne duhet të respektojmë këtë procedurë, pastaj të shkojmë tek procedura tjetër. Kështu që të evidentohen. Të lihet 5 ditë kohë, me e-mail të shprehin interesin se cili gjyqtar kërkon të vijë... në faqen e KLD-së. 2 ditë të tjera na duhet për të marrë pëlqimin e kryetarëve të gjykatave duke dhënë emrat e atyre që kanë shprehur interesin dhe pas 2 javësh mbaron e gjithë procedura zgjidhet.

Brunilda Kadi: Po analizën do e bëjë KLD-ja? Se mund të kërkojë dikush nga një gjykatë, por ajo gjykatë mund të mos ...

Gerd Hoxha: Prandaj do të merret mendimi i kryetarit të gjykatës.

Brunilda Kadi: Kjo do hapet në të gjithë gjykatat. Pra mund të ketë edhe nga Gjykata e Korçës, për shembull, që s'ka asnjë analizë.

Gerd Hoxha: Gjykata e Korçës, me sa di unë, është nga gjykatat që ka më pak punë. Nuk i prishet edhe sikur t'i ikin 2 gjyqtarë.

Brunilda Kadi: Atëherë, unë nuk jam plotësisht dakord me atë që tha Gerti sepse kjo do dojë edhe analizën nga ana e Këshillit për të gjitha këto gjykata ku do të ketë nga këto kërkesa. Dhe ne të gjithë biem dakord që kjo situatë nuk është normale dhe ne nuk jemi në kushtet ideale të nenit 46 edhe duke e bërë këtë. E kemi theksuar që, jemi në situatë emergjente dhe po bëjmë një interpretim të zgjeruar. Se nuk i qëndrojmë dot pikë për pikë nenit 46 dhe ideja pse është ajo dispozitë.

Gerd Hoxha: Okej! Pse është zgjedhur Përmeti atëherë?

Brunilda Kadi: Ja, një sekondë.

Dhe nuk mendoj se është e mjaftueshme...

Ja ta them si e lexoj unë raportin unë Gerti.

Gerd Hoxha: Në qoftë se ne duam të bëjmë qoka këtu, unë jam kundër qokave këtu. Nuk bëjmë qoka.

Brunilda Kadi: Unë mendoj që ajo që po propozon ti është me qoka.

Gerd Hoxha: Po respektoj ligjin.

Brunilda Kadi: Një sekondë, ta mbaroj Gerti.

Ideja është që mendimi i kryetarit nuk ka lidhje me analizën sepse siç e thotë edhe tek raporti, mendimi i kryetarit nuk është obligues për Këshillin por analiza e secilës nga gjykatat. Për shembull, meqë more rastin e Korçës, ne nuk e dimë se si është gjendja e Gjykatës së Korçës. Kryetari mund të thotë: -Okej, le të vijë iksi që ka bërë kërkesë, por gjendja e gjykatës së Korçës mund të jetë... kërkon analizë dhe ne i bie që analizojmë të gjitha gjykatat e Shqipërisë që të marrim pastaj këtë vendimin që propozon Gerdi. Unë besoj që raporti është bërë mbi bazën edhe të afërsisë gjeografike. Apo jo? Është edhe e sqaruar tek raporti, që kur vjen puna tek Kukësi, shikohen gjykatat përreth dhe shikohet cila nga gjykatat dëmtohet më pak dhe midis këtyre do shikojmë aty ku ka kërkesë. Për shembull, për Kavajën, meqenëse janë shprehur disa kërkesa, ne mund ta marrim në

shqyrtim sot dhe të zgjedhim atë personin me kriteret më objektive. Nuk besoj se ka pengesë për Kavajën për shembull sot.

Gerd Hoxha: Afërsia gjeografike nuk parashikohet më si kriter. Ka qenë më përpara.

Ilir Meta: Mirë! Më falni! Atëherë, unë mendoj që ajo procedura që tha Gerdi është më transparente. Nuk e di, do ta bëjmë vetëm për këto 5 gjykatat që kemi këtu në bazë të studimit, apo...?

Gjin Gjoni: Të fusim edhe administrativet. Apeli Administrativ, shkallën e parë të Durrësit Administrativ dhe Shkodrën.

Ilir Meta: Jemi dakord Marsida?

Marsida Xhaferllari: Neve, mendimin e kryetarëve të gjykatave për rreth e kemi marrë. Megjithatë, në qoftë se ju vendosni që të merret tek të gjitha gjykatat, ne në dispozicion jemi. E marrim.

Ilir Meta: Dhe pastaj gjykojmë në bazë të analizës tuaj. Mirë?

Dakord atëherë!

Jemi dakord me këtë mënyrë?

Po, urdhëro!

Urdhëro! Vetëm sa më konçiz.

Astrit Haxhialushi: Për sa i përket raportit të paraqitur nga Kryeinspektorja, mua më duket se është bërë një punë me të vërtetë serioze dhe njëkohësisht duke qenë një nga anëtarët më të vjetër të KLD-së, dua të vë në vëmendje të anëtarëve të tjerë të KLD-së, e kam këtu përpara, ne kemi një vendim të KLD-së "Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e një sërë çështjeve gjyqësore", njëkohësisht kam këtu përpara (kam qenë kryetar i atij komisioni) korrespondencën me OSBE-në dhe me EURALIUS-in dhe motamo, gjithë orientimet por edhe nenet përkatëse të këtij vendimi "Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve", i ka pasqyruar në raportin e vetë Kryeinspektorja. Çmoj që do të ishte më e arsyeshme dhe më e drejtë që delegimi i gjyqtarëve me periudhë të caktuar pranë gjykatave duhet të jetë me ato që kanë afërsi gjeografike me gjykatën kryesore.

Është e përcaktuar në vendimin e KLD-së edhe në marrëdhëniet...

Ilir Meta: Mos të kthehemi mbrapa. Ju lutem! Duhet të orientohemi në KLD drejt dhënies së zgjidhjeve. Koha për teori pa fund ka ikur. Jemi në fund të kësaj KLD-je.

Më fal! Të lutem! Të japim zgjidhje për problemet që na kërkohet me transparencën maksimale brenda kësaj situatë. Dakord?

Kështu që me duket se propozimi që tha Gerdi ishte më racional. U miratua. Të mos kthehemi mbrapa.

Petrit Çomo: Zoti Kryetar! Edhe unë jam dakord me atë, por duke lexuar këtë letrën e këtyre magjistratëve ne ndoshta mund të emërojmë ndoshta edhe këta persona që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, prandaj e ngrita.

Neritan Ceta: Unë jam pjesërisht dakord me Gerdin. Në ç'kuptim?

Nuk është se jemi në kushtet...

Ilir Meta: E morëm vendimin tani.

Do të fillojmë të gjithë nga e para.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Ema Gashi, për përfitimin e lejes së papaguar, për një periudhë jo më pak se 12 muaj dhe konkretisht për periudhën: prill 2018 – prill 2019, me të drejtë zgjatje të afatit të lejes së papaguar deri në 2 vjet.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Gerd Hoxha* (anëtar)

9. *Neritan Cena* (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Z. Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Ema Gashi, për përfitimin e lejes së papaguar, për një periudhë jo më pak se 12 muaj dhe konkretisht për periudhën: prill 2018 – prill 2019, me të drejtë zgjatje të afatit të lejes së papaguar deri në 2 vjet.

Ilir Meta: Atëherë, kalojmë tek 10-ta. Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Ema Gashi, për përfitimin e lejes së papaguar, për një periudhë jo më pak se 12 muaj dhe konkretisht prill 2018 – prill 2019, me zgjatje afati, etj.

Jemi dakord?

Dakord jemi?

Kundër?

Po!

Astrit Haxhialushi: Një raport i paraqitur nga grupi i punës i KLD-së “Mbi planin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i cili ka datën 30.12.2016. Për sa i përket lejes së gjyqtarëve, në konkluzion, dhe është miratuar ky raport në KLD, shprehimisht thuhet: “Nga analiza e këtyre dispozitave konstatohet se ato autorizojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor të miratojë rregulla të detajuara për dhënien e lejes për gjyqtarët. Ligji nr. 96 i vitit 2016 për dispozitat tranzitore nuk shprehet lidhur me kompetencat e KLD-së aktuale për të miratuar leje. Rrjedhimisht konkludohet se KLD-ja nuk mund të shqyrtojë më dhe të miratojë leje të gjyqtarëve që nënkupton se vendimi nr. 138/3, datë 19.03.2003 për lejet jo të zakonshmet gjyqtarëve, i ndryshuar, duhet të konsiderohet i shfuqizuar.”

Ky është raporti i miratuar në mbledhjen e KLD-së.

30.12.2016, dalë në zbatim të ligjit 96 të vitit 2016.

Ilir Meta: Po!

Gjin Gjoni: Pas kësaj, ka një vendimmarrje tjetër të këtij Këshilli, i cili ju nuk keni genë, i cili është ndryshuar vendimi nr. 138/3 dhe ka kaluar një vendim tjetër.

Astrit Haxhialushi: Vendimmarrja e Këshillit, në bazë të ligjit...

Gjin Gjoni: Po është vendimmarrje tjetër mbrapa, e cila ka lejuar.

Vendimi në lidhje me Ema Gashin u mor Astrit.

Ilir Meta: Më fal!

Zoti Pjerin pse është futur në rend dite kjo kërkesë e...

Ai s'është argument, në qoftë s'është respektuar ligji dhe rregulli.

Pjerin Prendi: Nuk ka vendimmarrje të KLD-së për këtë. Është thjesht një mendim i grupit të punës. S'ka vendimmarrje.

Illir Meta: Atëherë, u miratua.

Edhe unë do t'ju lutesha shumë. Shikojeni rendin e ditës më përpara dhe për çdo çështje dhe ju lutem, në kohën e duhur propozoni zgjidhjen e duhur. Se ju keni përvojë, keni eksperiencë dhe mund t'i verifikoni gjërat më përpara.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Mbi zbatimin e vendimit nr. 1431, datë 05.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, me palë paditëse Shpresa Beçaj.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Gjini Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Neritan Cena</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci, znj. Eneida Civici.**

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Xhezair Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 4: Zoti Astrit Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.**
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.**
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.**
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.**
- 12. Ekspert i USAID-it.**

RENDI I DITËS:

11. Mbi zbatimin e vendimit nr. 1431, datë 05.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, me palë paditëse Shpresa Beçaj.

(Zoti Haxhialushi largohet nga salla e mbledhjes.)

Ilir Meta: 11-ta: Mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me palë paditëse Shpresa Beçaj.

Dakord! E shtyjmë.

Vazhdojmë me 12-ën. Shqyrtimi i raportit mbi inspektimin e përbashkët të ankesës publike ndaj gjyqtarëve Guximtar Boçi, Blerta Çibuku, të Gjykatës Gjirokastrë "Për shkelje të rregullave të etikës dhe kryerjen e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit".

Petrit Çomo: Atë pikën mund ta kalojmë.

Illir Meta: Për këtë? Për pikën e mëparshme? 11-ën?

Petrit Çomo: A jemi ne këtu. Ne e kemi kuorumin.

Illir Meta: Jeni dakord? Ta shtyjmë apo ta...

Dakord! Kush është dakord me zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për zonjën Shpresa Beçaj? Kush është dakord?

Kundër?

Miratohet.

Po!

Brunilda Kadi: Atëherë, unë votova kundër se mendoj që ky Këshill nuk ka kompetencë që të bëjë emërimin, pavarësisht vendimit.

Ridvan Hado: Po me të njëjtin argument, edhe unë votova kundër, për arsye se mendoj që kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për emërimin nuk janë më dhe vendimi 34 i Gjykatës Kushtetuese nuk është se e shfuqizoi, por e quajti ligjin në pajtim me Kushtetutën.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi (1) Raportit “Mbi inspektimin e përbashkët të ankesës publike ndaj gjyqtarëve Guximtar Boçi e Blerta Çibuku të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrër për shkelje të rregullave të etikës dhe kryerjen e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit” të Inspektoratit të KLD-së dhe Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe shqyrtimi (2) Raportit të një anëtari të KLD-së “Mbikëqyrjen e verifikimit të sjelljes së inspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me ankesën e bërë publike në emisionin investigativ “Stop” të televizionit kombëtar Klan ndaj dy gjyqtarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor Gjirokastrër”.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Meta*** (kryetar)
- 2. Gjini Gjoni*** (anëtar)
- 3. Astrit Haxhialushi*** (anëtar)

4. *Vangjel Kosta* (anëtar)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Petrit Çomo* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Gerd Hoxha* (anëtar)
9. *Neritan Cena* (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci*, znj. *Eneida Civici*.

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Xhezair Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi (1) Raportit “Mbi inspektimin e përbashkët të ankesës publike ndaj gjyqtarëve Guximtar Boçi e Blerta Çibuku të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë

për shkelje të rregullave të etikës dhe kryerjen e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit” të Inspektoratit të KLD-së dhe Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe shqyrtimi (2) Raportit të një anëtari të KLD-së “Mbikëqyrjen e verifikimit të sjelljes së inspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me ankesën e bërë publike në emisionin investigativ “Stop” të televizionit kombëtar Klan ndaj dy gjyqtarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor Gjirokastrë”.

(Anëtarët e Këshillit fillojnë shqyrtimin e pikës 12 të rendit të ditës, pikë e cila u prezantua gjatë shqyrtimit të pikës 11.)

Marsida Xhaferllari: Atëherë, ky inspektim është kryer me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. U zhvillua në tre faza, duke respektuar procedurën e përcaktuar në ligj, në Rregulloren e Inspektoratit dhe në manualin e inspektimeve.

(Hyn në sallën e mbledhjes zoti Haxhialushi.)

Në përfundim të këtij inspektimi është konkluduar mbajtja në verifikim në vijim e ankesës publike bërë në emisionin televiziv "STOP" për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë Guximtar Boçi, njëherazi kryetar i gjykatës, deri në zbardhjen e auto-regjistrimit nga Prokuroria për Krime të Rënda. Deri në këto momente që po shqyrtohet ky raport, shkak i verifikimit në vijim nuk ka rënë ende për këtë gjyqtar, pasi çështja penale e tij është bërë konflikt gjyqësor dhe jemi në pritje të shpalljes së vendimit nga gjykata.

Së dyti, është konkluduar përcjellja e relacionit bashkë me dokumentacionin shoqërues ministrit të Drejtësisë, për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarës Blerta Çibuku për shkak të kryerjes së akteve dhe sjelljeve prej saj të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.

Këtij raporti i është bashkëngjitur edhe raporti i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, zotit Gerd Hoxha, “Mbi verifikimin e veprimtarisë së inspektores Hajrie Muçmata”, që besoj jua relaton vetë zoti Hoxha konkluzionin e këtij raporti.

Gerd Hoxha: Faleminderit, zoti President!

Faleminderit, Marsida!

Sikundër e theksoi Marsida, është bërë një raport inspektimi lidhur me rastin në fjalë, marrë shkas nga një emision investigativ në Televizionin Klan, emisioni "STOP". Është urdhëruar një inspektim si kundër gjyqtarëve, ashtu edhe kundrejt inspektorëve që kanë inspektuar rastin në fjalë. Është përgatitur një raport me Nr. 2184 prot., datë 05.07.2017. Gjatë inspektimit janë marrë të dhëna dhe janë pyetur inspektorët në fjalë, personalisht nga ana ime. Po bëj një përmbledhje të shkurtër. E keni raportin.

Është zhvilluar inspektimi mbi bazën e ligjit 8811, të ndryshuar dhe neni 160 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve".

Ilir Meta: Domethënë, jemi për t'ia kaluar këtë raport Ministrisë?

Gerd Hoxha: Unë jam dakord.

...një sintezë/një paragraf.

Në përfundim unë them që është kryer raporti. Është vlerësuar drejt situata. Janë kryer të gjitha detyrat e lëna...

Ilir Meta: Atëherë, t'ia kalojmë këtë raport, t'ia përcjellim Ministrisë së Drejtësisë që të paraqesë propozimin për procedim disiplinor?

Jemi dakord?

Po, kundër...

Gerd Hoxha: Do thosha. Sa i përket raportit nga ana ime, unë sugjeroj arkivimin e këtij inspektimi në fund (për inspektorët).

Ilir Meta: Dakord!

Gerd Hoxha: Për inspektorët, unë sugjeroj arkivimin, pasi nuk janë konstatuar shkelje të inspektorëve gjatë trajtimit të kësaj çështjeje.

Ilir Meta: Dakord!

Gerd Hoxha: Unë kisha inspektimin e inspektorëve. Jo inspektimin e gjyqtarit.

Ilir Meta: Dakord! E kanë parasysh.

Atëherë, kalojmë tek pika 13.

Gerd Hoxha: Jo, jo, kjo s' di t' i kalojë ministrisë. Të arkivohet.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

[Shqiptaria.com]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës nr. 304 prot., datë 23.01.2018 së inspektorese së Inspektoratit të KLD-së znj. Sofie Zhilla, për të vijuar me një mandat të dytë në detyrën e inspektorit, pranë IKLD-së.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** (kryetar)
2. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
3. ***Astrit Haxhialushi*** (anëtar)
4. ***Vangjel Kosta*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Petrit Çomo*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Gerd Hoxha*** (anëtar)

9. Neritan Cena

(anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci, znj. Eneida Civici.**

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Xhezair Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.**
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.**
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.**
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.**
- 12. Ekspert i USAID-it.**

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i kërkesës nr. 304 prot., datë 23.01.2018 së inspektore së Inspektoratit të KLD-së znj. Sofie Zhilla, për të vijuar me një mandat të dytë në detyrën e inspektorit, pranë IKLD-së.

Ilir Meta: Kalojmë tek 13-ta.

Shqyrtimi i kërkesës nr. 304 prot., datë 23.01.2018 së inspektores së Inspektoratit të KLD-së znj. Sofie Zhilla, për të vijuar me një mandat të dytë në detyrën e inspektorit, pranë IKLD-së.

Gjin Gjoni: Dakord jemi zoti President. Vetëm duhet ‘deri në krijimin e Inspektoratit të Lartë. Kaq.

Ilir Meta: Është e qartë ajo.

Gjin Gjoni: Jo, se mandati mund të jetë 6-mujor, mund të jetë 4-mujor.

Ilir Meta: Atëherë, me këtë saktësim, jemi dakord?

Miratohet! Jemi dakord?

Miratohet!

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2010 - 2012, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” për:

1. Gjyqtari Ervin Pollozhani, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Gjyqtari Lazër Sallaku, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Gjyqtari Ervin Metalla, Gjykata e Apelit Tiranë.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------|
| 1. <i>Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| 2. <i>Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 4. <i>Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |

5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Petrit Çomo* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Gerd Hoxha* (anëtar)
9. *Neritan Cena* (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Xhezair Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2010 - 2012, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të

Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” për:

1. Gjyqtari Ervin Pollozhani, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Gjyqtari Lazër Sallaku, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Gjyqtari Ervin Metalla, Gjykata e Apelit Tiranë.

Ilir Meta: Vazhdojmë me pikën tjetër, 14-ën. Shqyrtimin e projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit të Kryeinspektorit të IKLD-së për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” për: Gjyqtarin Ervin Pollozhani, Lazër Sallaku dhe Ervin Metalla. Të Tiranës janë.

Atëherë, për këtë çfarë mendimi kemi?

Jemi dakord?

Kush është dakord?

Pro?

Kundër?

Do ta tërhiqni për Lazër Sallakun?

Marsida Xhaferllari: Për Lazrin duhet ta shtyjmë sepse ka një gabim material projekt-akti në fund në tabelën përfundimtare dhe t’ia njoftojmë edhe një herë.

Ilir Meta: Okej, atëherë miratohet për Ervin Pollozhani dhe Ervin Metallën.

Për Lazër Sallakun tërhiqet. Do të riparaqitet.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 15 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së 5 anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi përfshirjen në rendin e ditës të kërkesës së gjyqtares Pajtime Fetahu për shfuqizimin e vendimit nr. 12, datë 07.02.2017 të KLD-së.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** (kryetar)
2. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
3. ***Astrit Haxhialushi*** (anëtar)
4. ***Vangjel Kosta*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Petrit Çomo*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Gerd Hoxha*** (anëtar)

9. Neritan Cena

(anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci, znj. Eneida Civici.**

Shënim 2: Znj. Etilda Gjonaj nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Xhezair Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
2. **Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
4. **Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
6. **Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
7. **Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.**
8. **Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.**
9. **Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.**
10. **Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.**
11. **Eksperte e Misionit EURALIUS.**
12. **Ekspert i USAID-it.**

RENDI I DITËS:

15 Shtesë. Shqyrtimi i kërkesës së 5 anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi përfshirjen në rendin e ditës të kërkesës së gjyqtarës Pajtime Fetahu për shfuqizimin e vendimit nr. 12, datë 07.02.2017 të KLD-së.

Ilir Meta: Kalojmë tek çështja që ngritet ju në rendin e ditës?

Kush është propozimi, propozimi që është bërë herën e kaluar nga pesë anëtarë?

Gjin Gjoni: Propozimi ka qenë që të rikthehet në pozicionin e punës për shkak se nuk ka çështje penale dhe e dyta, ka një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, i cili është vendim i formës së prerë, dhe gjyqtarja duhet të kthehet në detyrë.

Po pra, anulimin e vendimit të pezullimit.

Gerd Hoxha: Shkaqet e pezullimit janë dy: është vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar nenin 152 për pezullimin e diskrecionit. Ne që në atë moment duhet ta kishim bërë. Megjithatë është për ta mbështetur më fort argumentin, kemi edhe një vendim të Prokurorisë ku është vendosur pushimi i çështjes penale ndaj të nderuarës gjyqtare. Aq më tepër edhe kjo e treta, se duhet t'i marrim të treja kushtet. Ne jemi të detyruar. Nuk mund të dalim jashtë vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë dhe Gjykatës Administrative. Të rikthehet në punë, duke përfituar edhe pagesën. Revokohet vendimi, nga dita që ka ngelur pa punë, deri më sot.

Ilir Meta: Atëherë, kush është dakord me propozimin e bërë formalisht nga 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas procedurave?

Kundër?

Pra, me votën time kundër, miratohet ky propozim.

* * *

(Pika 15 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Delegimet.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-------------------------|------------------|
| 1. Ilir Meta | (kryetar) |
| 2. Etilda Gjonaj | (anëtare) |
| 3. Gjini Gjoni | (anëtar) |
| 4. Vangjel Kosta | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Petrit Çomo | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Gerd Hoxha | (anëtar) |
| 9. Neritan Cena | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Artan Broci, znj. Eneida Civici.**

Shënim 2: Zoti Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.*
- 12. Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

16. Delegimet.

Marsida Xhaferllari: Paraprakisht çështjeve të delegimeve, ka dy çështje paraprake. Së pari, lidhet me një kërkesë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë që ka bërë kërkesë për delegim gjyqtari, për gjykimin e një kërkesë penale me objekt “Zëvendësim mase sigurimi”, por ndërkohë e ka tërhequr këtë kërkesë sepse i është realizuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në mbledhjen e fundit. Kjo është thjesht për dijeni.

Së dyti, janë dy kërkesa të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin për dy çështje të ndryshme, një civile dhe një penale, njëra është ndreqje gabimi dhe tjetra është plotësim vendimi, ku nga kryetari i gjykatës sugjerohet që për këto dy çështje të delegohet i njëjti gjyqtar që ka marrë pjesë në çështjen e themelit.

Atëherë, për çështjen nr. 1 hidhet shorti mes gjykatave: apel Korçë, apel Vlorë, apeli i krimeve të rënda.

Gerd Hoxha: Apeli Vlorë.

Marsida Xhaferllari: Apeli Vlorë.

3 gjyqtarë nga apeli Vlorë.

Gerd Hoxha: Hysen Saliko.

Marsida Xhaferllari: Hysen Saliko.

Gerd Hoxha: Skënder Damini, Petrit Aliaj.

Marsida Xhaferllari: Skënder Damini, Petrit Aliaj.

Vijojmë po aty, 3 gjyqtarë për çështjen nr. 2.

Gerd Hoxha: Petrit Aliaj, Skënder Damini, Hysen Saliko.

Marsida Xhaferllari: Petrit Aliaj, Hysen Saliko, Skënder Damini.

Për të shkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, shorti mes gjykatave: apel Vlorë, apel Durrës, apeli i krimeve të rënda.

(Përzgjidhet apeli Durrës.)

Apeli Durrës.

3 gjyqtarë për të shkuar në Korçë.

(Hyn në sallën e mbledhjes ministrja e Drejtësisë dhe largohet nga mbledhja dhe nuk merr më pjesë në zhvillimin e saj zoti Haxhialushi.)

Brunilda Kadi: Arjan Balliu.

Marsida Xhaferllari: Arjan Balliu.

Brunilda Kadi: Anita Mici.

Marsida Xhaferllari: Anita Mici.

Brunilda Kadi: Valbon Çekrezi.

Marsida Xhaferllari: Vijojmë po aty për çështjen nr. 4, 2 gjyqtarë.

Brunilda Kadi: Anita Mici.

Marsida Xhaferllari: Anita Mici.
Edhe një tjetër.

Brunilda Kadi: Arben Vrioni.

Marsida Xhaferllari: Arben Vrioni.
Për çështjen nr. 5 për të shkuar në apel Shkodër, shorti midis gjykatave: apel Durrës, apel Vlorë, apel Tiranë, krimet e rënda.

Brunilda Kadi: Krimet e rënda.

Marsida Xhaferllari: Krimet e rënda, 1 gjyqtar për çështjen nr. 5.

Brunilda Kadi: Saida Dollani.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani.
Nga rrethi gjyqësor Sarandë, në rrethin gjyqësor Gjirokastrë, për çështjen nr. 6, 1 gjyqtar. Enkeleda Doda dhe Sokol Pina kanë pengesë. Midis Ketra Bajramit dhe Nevrie Dukës.

Brunilda Kadi: Ketra.

Marsida Xhaferllari: Ketra Bajrami.
Nga rrethi gjyqësor Durrës në rrethin gjyqësor Kavajë, 1 gjyqtar nga dhoma penale. (Çështja nr. 7.)

Brunilda Kadi: Nurjeta Tafa.

Marsida Xhaferllari: Nurjeta Tafa.
Nga dhoma penale, po aty, për tetën, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 8.)

Brunilda Kadi: Eda Kaja.

Marsida Xhaferllari: Eda Kaja.
Tek çështja nr. 9, nga Kurbini në Krujë, 1 gjyqtar.

Brunilda Kadi: Aurel Arapi.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.
Po aty, 1 gjyqtar për çështjen nr. 10, nga Kurbini në Krujë. 1 gjyqtar.

Brunilda Kadi: Marcela Shehu.

Marsida Xhaferllari: Marçela Shehu.
Nga Lezha në Kurbin, 1 gjyqtar. Jo Ilir Përdeda. Për 11-tën.

Brunilda Kadi: Jak Ndoka.

Marsida Xhaferllari: Jak Ndoka.
Çështja nr. 12 u vendos, që ishte parashtruar tek kërkesat paraprake.
Iilir Përdeda dhe Nazmie Pengili.
Për çështjen nr. 13, nga Tropoja në Kukës, 1 gjyqtar. Midis Erjon Çelës dhe Sami Ujkashit.

Brunilda Kadi: Sami Ujkashi.

Marsida Xhaferllari: Sami Ujkashi.

Po aty, 1 gjyqtar tjetër për 14-ën.

Brunilda Kadi: Erjon Çela.

Marsida Xhaferllari: Erjon Çela.

Po aty, 1 gjyqtar për 15-ën.

Brunilda Kadi: Sami Ujkashi.

Marsida Xhaferllari: Sami Ujkashi.

Tek 16-ta nga rrethi gjyqësor Vlorë në rrethin gjyqësor Sarandë, 2 gjyqtarë nga dhoma penale.

Brunilda Kadi: Atalanta.

Marsida Xhaferllari: Atalanta Zeqiraj.

Brunilda Kadi: Arbana Selmani.

Marsida Xhaferllari: Arbana Selmanaj.

Nga rrethi gjyqësor Shkodër në Tropojë, 3 gjyqtarë. Nga Dhoma penale. (Çështja nr. 17.)

Brunilda Kadi: Luveda Dardha.

Marsida Xhaferllari: Luveda Dardha.

Brunilda Kadi: Tonin Stërkaj.

Marsida Xhaferllari: Tonin Stërkaj.

Edhe një tjetër.

Brunilda Kadi: Sokol Shehu.

Marsida Xhaferllari: Sokol Shehu.

Nga Puka në Tropojë, 1 gjyqtar midis Gentian Markut dhe Flutura Hoxhës.
(Çështja nr. 18.)

Brunilda Kadi: Flutura.
Marsida Xhaferllari: Flutura Hoxha.
Tek shtesat.
Shorti mes apeleve: apel Korçë, apel Vlorë, apeli i krimeve të rënda, për të shkuar në Gjirokastrë.

Brunilda Kadi: Krimet e rënda.

Marsida Xhaferllari: Krimet e rënda.

2 gjyqtarë tek shtesa 1.

Brunilda Kadi: Sokol Binaj dhe Dhimitër Lara.

Marsida Xhaferllari: Sokol Binaj dhe Dhimitër Lara.

Vijojmë po aty, 1 gjyqtar për çështjen nr. 2 tek shtesa.

Brunilda Kadi: Nure Dreni.

Marsida Xhaferllari: Nure Dreni.

Në apel Korçë shorti mes gjykatave: apel Gjirokastrë, apel Vlorë, apeli Durrës dhe apeli i krimeve të rënda. Për të shkuar në apel Korçë.

Brunilda Kadi: Krimet e rënda.

Marsida Xhaferllari: Krimet e rënda.

1 gjyqtar, për 3-shin.

Brunilda Kadi: Dhimitër Lara.

Marsida Xhaferllari: Dhimitër Lara.

Vijojmë po aty, 1 gjyqtar tjetër. Për 4-ën tek shtesat.

Brunilda Kadi: Dhurata.

Marsida Xhaferllari: Dhurata Haveri.

Tek 5-sa po aty, 3 gjyqtarë.

Brunilda Kadi: Nure Dreni.

Marsida Xhaferllari: Nure Dreni.

Brunilda Kadi: Albana Boksi.

Marsida Xhaferllari: Albana Boksi.

Brunilda Kadi: Saida Dollani.

Marsida Xhaferllari: Saida Dollani.

Nga Mati në Dibër, 1 gjyqtar.

Brunilda Kadi: Murat Lleshi.

Marsida Xhaferllari: Murat Lleshi për 6-ën.

Për 7-ën nga Mati në Dibër, 1 gjyqtar. Jo i njëjti gjyqtar si tek kërkesa 6. Pra jo Murati. Se janë të lidhura.

Brunilda Kadi: Ali Koleci.

Marsida Xhaferllari: Ali Koleci.

Tek 8-ta është kjo që u miratua, është Ilir Përdeda që u miratua tek çështjet paraprake.

Tek 9-ta, nga Kruja në Kurbin, 1 gjyqtar.

Brunilda Kadi: Enkeleda Hoxha.

Marsida Xhaferllari: Enkeleda Hoxha.

Tek 10-ta nga Kurbini në Lezhë, 1 gjyqtar.

Brunilda Kadi: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

Tek 11-ta, 1 gjyqtar nga Kurbini në Lezhë. Po aty.

Brunilda Kadi: Marcela Shehu.

Marsida Xhaferllari: Marcela Shehu.

Dhe tek 12-ta, 1 gjyqtar. Po aty. Nga Lezha në Shkodër, tek 12-ta, 1 gjyqtar.

(Përzgjidhet Ilir Përdeda.)

Ilir Përdeda.

Hidhet shorti midis gjykatave: apel Korçë, apel Vlorë, apeli i krimeve të rënda, për të shkuar në Gjirokastër. (Çështja nr. 1, shtesat 2.)

Brunilda Kadi: Krimet e rënda.

Marsida Xhaferllari: 2 gjyqtarë.

Brunilda Kadi: Idrizi, Sokol.

Marsida Xhaferllari: Idriz Mulkurti dhe Sokol Binaj.

Shorti mes gjykatave për të shkuar në apel Vlorë: apeli Korçë, apeli Shkodër, apeli Durrës, apeli i krimeve të rënda. (Çështja nr. 2.)

Brunilda Kadi: Apeli Durrës.

Marsida Xhaferllari: Apeli Durrës.

Apeli Durrës, 3 gjyqtarë.

Brunilda Kadi: Arben Vironi.

Marsida Xhaferllari: Arben Vironi.

Brunilda Kadi: Arjan Balliu.

Marsida Xhaferllari: Arjan Balliu.

Brunilda Kadi: Dhe Valbon Çekrezi.

Marsida Xhaferllari: Valbon Çekrezi.

Po aty, 1 gjyqtar. (Çështja nr. 3.)

Brunilda Kadi: Izet Dushaj.

Marsida Xhaferllari: Izet Dushaj.

Po aty, 2 gjyqtarë. (Çështja nr. 4.)

Brunilda Kadi: Çekrezi dhe Mici.

Marsida Xhaferllari: Valbon Çekrezi dhe Anita Mici.

Nga rrethi Tiranë në rrethin gjyqësor Elbasan. Jo Kujtim Vraniçi. Nga dhoma penale e Tiranës, në rrethin gjyqësor Elbasan, por jo Vraniçi, se ka pengesë. (Çështja nr. 5.)

Brunilda Kadi: Oltjona.

Marsida Xhaferllari: Oltjona Goxhaj.

Nga rrethi gjyqësor Kurbin në rrethin gjyqësor Lezhë. Mes Marcela Shehut dhe Aurel Arapit. Se Ded Miri ka pengesë. (Çështja nr. 6.)

Brunilda Kadi: Aurel Arapi.

Marsida Xhaferllari: Aurel Arapi.

Tek 7-ta, nga Kurbin në Krujë, 1 gjyqtar.

Brunilda Kadi: Ded Miri.

Marsida Xhaferllari: Ded Miri.

Dhe e fundit, nga rrethi gjyqësor Gjirokastrë në rrethin gjyqësor Sarandë, 2 gjyqtarë.

Brunilda Kadi: Mirela dhe Dosti.

Marsida Xhaferllari: Mirela dhe Arben Dosti.

Ilir Meta: Atëherë, mbaruam edhe me delegimet.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Laurent Fuçia (masa disiplinore e propozuar “Vërejtje me paralajmërim”).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Etilda Gjonaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Neritan Cena</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Zoti Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 4: Zoti Hoxha nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
- 8. Besmir Beja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.*
- 9. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
- 10. Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
- 11. Eksperte e Misionit EURALIUS.*
- 12. Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Laurent Fuçia (masa disiplinore e propozuar “Vërejtje me paralajmërim”).

Fillojmë me pikën e parë. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit Laurent Fuçia, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Masa disiplinore e propozuar “Vërejtje me paralajmërim”.

Të vijë shpejt gjyqtari.

Të bëhet gati Petraq Çuri.

Gerd Hoxha: Zoti President!

Përpara se të vijë.

Në mbledhjen e kaluar unë kam paraqitur një argument për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj mase disiplinore, për shkak të një konflikti të këtij gjyqtari me një familjarin tim, të një çështjeje që ka gjykuar. Kështu që...

Unë e kam të pamundur.

Pro tij nuk votoj dot. As kundër nuk votoj.

Ai zotëria ka marrë një vendim gjyqësor kundër një. Kuorumi është. Por ministrja nuk voton.

Ilir Meta: Vetëm për këtë çështje?

Gerd Hoxha: Vetëm për këtë çështje.

Ilir Meta: Dakord!

(Zoti Hoxha largohet nga salla dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj pike.)

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari Laurent Fuçia.)

Po, atëherë, çfarë shpjegimi do jepnit ju.

Në mënyrë koncize.

Laurent Fuçia: I nderuar zoti President i Republikës!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë!

Bazuar në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si dhe bazuar në nenet 141, 142 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashtrimet e mia i kam me shkrim, gjithsej janë 7 fletë të riprodhuara në 11 kopje. Për efekt të sekretarisë po jua vë në dispozicion.

Shkurtimisht atëherë, në mënyrë verbale po i paraqes ato.

Atëherë, vlerësoj se kërkesa e ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor është e pabazuar në ligj, për shkak se qoftë nga raporti i inspektimit i hartuar nga ana e inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë, qoftë edhe nga kërkesa e paraqitur nga ana e ministrit të Drejtësisë, rezulton se motivi kryesor mbi të cilën është bazuar kërkesa lidhet

me aspekte të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin, bërë nga ana e gjyqtarit të çështjes, të normave procedurale lidhur me arrestin në flagrancë dhe caktimin e masave të sigurimit.

Në lidhje me këtë moment, gjykoj dhe vlerësoj që këto janë aspekte të cilat në bazë të nenit 4, 135 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mund dhe duhet të përbëjnë në çdo rast lëndë shqyrtimi për gjykatën më të lartë, sipas parimit të organizimit dhe të funksionimit të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Që do të thotë, në një rast të tillë është detyrë dhe kompetencë kushtetuese në vlerësimin tim vetëm e Gjykatës së Apelit ose gjykatës më të lartë në rastet e ankimimit ndaj vendimit, për të vlerësuar bazueshmërinë në ligj dhe në prova, të një vendimi gjyqësor të marrë nga gjykata më e ulët. Ky përfundim mbështetet qoftë nga normat kushtetuese dhe normat ligjore në fuqi, por qoftë edhe nga praktika gjyqësore. Konkretisht më lejoni t'ju citoj vendimin nr. 289, datë 18.04.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili në një rast analog, ndër të tjera ka arritur në këtë konkluzion: Kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë i tërheq vëmendjen Këshillit të Lartë të Drejtësisë se nuk është misioni i këtij organi kushtetues për të vlerësuar bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimeve gjyqësore, qofshin këto të formës së prerë ose jo. Si një organ që procedon disiplinarisht gjyqtarët, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të vlerësojë vetëm aspektet formale të punës së një gjyqtari, për shembull respektimi i solemnitetit në gjykim, i etikës gjatë dhe pas kohës së punës, frekuentimi i rregullt i punës, moszvarritja...

Ilir Meta: Të lutem! A bëjnë më mirë pyetje anëtarët e Këshillit, sesa...

Laurent Fuçia: Si ta vlerësoni ju!

Ilir Meta: Se kam përshtypjen që mos të themi gjëra që anëtarët i dinë, se kanë shumë përvojë.

Laurent Fuçia: Nëse më lejoni zoti President i Republikës, vetëm një argument doja që të mos e anashkaloja. Kërkesa e ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor është paraqitur mbi bazën e ligjit të vjetër për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë dhe konkretisht neni 32, pika 2, germa /ç/. Aktualisht sot që po shqyrtohet kjo kërkesë përpara këtij Këshilli të nderuar, rezulton që ka hyrë në fuqi ligji nr. 96 i vitit 2016, i cili në kreun e shkeljeve disiplinore dhe masave disiplinore është shfuqizuar me vendimin e datës 10 prill 2017 të Gjykatës Kushtetuese,

që do të thotë, në rastin konkret, ndodhemi përpara një ometimi legjislativ në lidhje me shkelje disiplinore dhe masa disiplinore të cilat kanë të bëjnë gjatë procedurës disiplinore të një magjistrati. Vlerësoj se kjo, sipas edhe parimit juridiko-penal apo kushtetues të zbatimit të ligjit favorizues, në rastin konkret, shkeljet disiplinore dhe masat disiplinore në lidhje me gjyqtarët mungojnë. Pra ka ometim legjislativ. Megjithatë, përpos këtij fakti edhe në rast se nuk do të kishte ometim legjislativ, jam i mendimit që aktet dhe sjelljet që diskreditojnë figurën e gjyqtarit, në vlerësimin tim personal si gjyqtar, janë të një kategorie të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të gjyqtarit në lidhje me vlerësimin e provave dhe vlerësimin e ligjit procedural dhe material përkatës. Kjo sepse edhe Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim në lidhje me këtë nocion ligjor të papërcaktuar. Pra cilat do të konsiderohen akte dhe sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit? Janë ato që lidhen me respektimin e etikës dhe jo ato që lidhen me bindjen e brendshme. Faleminderit!

Ilir Meta: Kush ka pyetje?

Ka dikush pyetje?

Në qoftë se s'ka pyetje... Ministrja ka ndonjë mendim?

Etilda Gjonaj: ...një relativitet të propozimit të ministrit edhe duke mbajtur në konsideratë atë çfarë gjyqtari tha për sa i përket shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të llojit të shkeljeve por në fakt lë në fuqi dhe vazhdojnë të lënë në fuqi masa disiplinore dhe është e vërtetë që propozimi që ministri i Drejtësisë së mëparshëm ka bërë lidhur me masën ndaj gjyqtarit që është “Vërejtja me paralajmërim”, sot është e shfuqizuar, nuk parashikohet më si masë disiplinore, por në vend të saj parashikohet masa “Vërejtje konfidenciale” dhe “Vërejtje publike”. Dhe sa më sipër, vlerësohet që referimi i llojit të shkeljes mund të vijojë të bëhet sipas ligjit të mëparshëm në kushtet kur s'ka ende një dispozitë të plotësuar, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimmarrjen e mbledhjeve të mëparshme të kësaj KLD-je, por që gjithsesi mendojmë që nga ana jonë vlerësohet se mund të propozohet si masë disiplinore “Vërejtja publike”. Përfundimisht, duke iu referuar edhe kriterëve për caktimin e masës disiplinore të parashikuar nga neni 115 i ligjit 96/2016 dhe bazuar në nenin 160, paragrafi i parë, germa /c/ të po këtij ligji, i

propozojmë Këshillit të Lartë të Drejtësisë vendosjen e masës disiplinore të “Vërejtjes publike” ndaj gjyqtarit.

Ilir Meta: Faleminderit!

Laurent Fuçia: Ju kërkoj ndjesë për terminologjinë.

Faleminderit!

Në lidhje me parashtrimin që sapo bëri ministrja e Drejtësisë, parimi i përgjithshëm i së drejtës kushtetuese është parimi i sigurisë juridike dhe i qartësisë së normave, si shprehje e shtetit të së drejtës. Që do të thotë: shkeljet disiplinore dhe masat disiplinore duhet të jenë të parashikuara në mënyrë tekstuale të qartë, pa ekuivoke nga ligjvënësi. Ky rezultat mbështetet edhe në vendimin 34, datë 10.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (fq. nr. 42, nëse më lejoni ta citoj): “Nga analiza në tërësi e përmbajtjes së këtyre normave ligjore, gjykata vëren se mënyra e formulimit të tyre nuk plotëson kërkesën kushtetuese për qartësi, qëndrueshmëri, besueshmëri dhe efektivitet. Veçanërisht për shkak të rëndësisë që kanë për magjistratin pasojat që sjell shkelja disiplinore, gjykata vlerëson se terminologjia e përdorur dhe teknika legislative e hartimit të tyre, ngre dyshime serioze mbi kuptueshmërinë e ndryshme të tyre, çka mund të rezultojë në pasoja negative serioze për statusin e magjistratit dhe përfitimet që lidhen me të”. Faleminderit!

(Gjyqtari Laurent Fuçia largohet nga salla e mbledhjes.)

Ilir Meta: Atëherë, kush ka ndonjë mendim para se të shprehemi?

S’ka mendime!

Atëherë, kush është dakord me këtë propozim të Ministrisë së Drejtësisë?

Fillojmë, Ilir Meta, po!

Gjin Gjoni: Kundër!

Vangjel Kosta: Kundër!

Brunilda Kadi: Kundër!

Petrit Çomo: Kundër!

Ridvan Hado: Kundër!

Neritan Cena: Kundër!

Ilir Meta: Nuk miratohet.

Propozim tjetër?
Ka propozim tjetër?
S'ka propozim tjetër.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Petraq Çuri (masa disiplinore e propozuar “Shkarkim nga detyra”).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Etilda Gjonaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Zoti Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Petraq Çuri (masa disiplinore e propozuar “Shkarkim nga detyra”).

Ilir Meta: Vazhdojmë me pikën 2.

Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Petraq Çuri. Për “Shkarkim nga detyra”.

Të lajmërohet edhe Gerdi.

Të vijë të dy.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari Petraq Çuri.)

Etilda Gjonaj: Për sa i përket kësaj çështjeje, e cila ka qenë në rend dite në fakt edhe në mbledhjen e datës 24 janar 2018 por është shtyrë pasi gjyqtari nuk është paraqitur. Me shkresën e datës 09.01.2018, ministri i Drejtësisë i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, zotit Petraq Çuri dhe marrjen e masës disiplinore ndaj atij të “Shkarkimit nga detyra”. Kërkesa bazohet në konstatimet e dala nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektorati i KLD-së. Ky hetim disiplinor është iniciuar nga ankesa e datës 12.07.2017 e ish ministrit të Drejtësisë zotit Bardhi, lidhur me vendimin e datës 11.07.2017 për mosmiratimin e arrestit të dhënë nga gjyqtari Çuri. Me këtë vendim është liruar një shtetas i cili kërkohet nga Italia për trafik droge. Gjyqtari Petraq Çuri nuk ka pranuar kërkesën e Prokurorisë për caktim mase sigurie “arrest në burg” me qëllim ekstradimi.

(Hyn në sallën e mbledhjes zoti Hoxha.)

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin e datës 18.07.2017 ka filluar hetimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në përfundim ka konkluduar se: ky gjyqtar ka kryer shkelje të rënda profesionale në dhënien e vendimit për mosmiratimin e arrestit të shtetasit Alket Hatija dhe lirim të tij dhe 2) shkeljet e mësipërme përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor referuar nenit 140, pika 2, shkronja /a/ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Me shkresën e datës 17.11.2017, Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i ka përcjellë ministrit të Drejtësisë raportin e hetimit disiplinor, pasi ka vlerësuar se sipas nenit 160, paragrafi i parë, germa /c/ i ligjit 96/2016, një ndër kompetencat e KLD-së në këtë periudhë tranzitore është vendosja e masave disiplinore me propozim të ministrit të Drejtësisë.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara përgjatë hetimit disiplinor të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë provohet se gjyqtari, në vendimmarrjen e tij, ka kryer shkelje të rënda profesionale që konsistojnë në moszbatimin e nenit 495 të

K.Pr.Penale, si dhe të nenit 38 të ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar. Dhe gjithashtu, neni 38, po prapë i ligjit, parashikon edhe procedurën që duhet të ndiqet në rastin e urdhrit ndërkombëtar të arrestit të shtetasve shqiptarë. Gjyqtari në këtë rast ka disponuar ndryshe nga vetë praktika e tij. Gjyqtari ka vite në profesion, çka nënkupton që në vendimin e dhënë për shtetasin në fjalë, këto shkelje profesionale janë kryer me dashje dhe jo për shkak të mangësive profesionale apo mungesës së përvojës.

Në interpretim të nenit 140, paragrafi i parë i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ministri i Drejtësisë, në vështrim gjithashtu edhe të nenit 115 të ligjit nr. 96/2016 për kriteret e caktimit të masave disiplinore, duke patur në konsideratë edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, 10.04.2017 vlerëson se jemi përpara rastit kur duhet të gjejë zbatim pikërisht neni 140, paragrafi i dytë, germa /a/ e Kushtetutës.

Dhe për këtë arsye, ministri i Drejtësisë, ka vlerësuar se deri në krijimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, në interpretim edhe të Gjykatës Kushtetuese dhe në bazë të praktikës që ka ndjekur KLD-ja për vendimmarrje dhe procese të tilla, të mund dhe t’i kërkojë Këshillit të Lartë të Drejtësisë të vendosë masën disiplinore të “Shkarkimit nga detyra” të gjyqtarit Petraq Çuri. I ngelem kësaj mase.

Ilir Meta: Faleminderit!

Zoti Petraq, juve në mënyrë koncize. Nuk do të donim të dëgjonim një raport të gjatë, se nuk na ndihmon edhe ne për t’u përqendruar, plus që e kanë paraprakisht anëtarët e KLD-së qëndrimin tuaj, por thelbin e qëndrimit tuaj për këtë çështje.

Petraq Çuri: I nderuar, zoti President!

Të nderuar anëtarë të KLD-së!

Unë do mendoja që ministrja e Drejtësisë do të hiqte dorë në këtë mbledhje nga kërkesa e saj për një fakt të ri që ka ndodhur gjatë këtyre kohëve, që nga momenti që nga ana e Kryeinspektores është bërë materiali për largimin tim nga detyra e deri në momentin që unë po dalë përpara jush, për shkak se Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e saj, të cilin unë jua kam paraqitur të gjithë anëtarëve të KLD-së, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për ekstradim të shtetasit Alket Hatija, dhe sot Alket Hatija është i lirë në Durrës. Pra që nga data 5 mars të vitit

2018, Alket Hatija është i lirë në Durrës, për shkak sepse Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, pasi e shqyrtoi çështjen e ngritur nga Prokuroria për ekstradimin e shtetasit Alket Hatija, e konsideroi të paligjshme për dy arsye: elementi i parë është sepse kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Krimeve të Rënda me nr. 10/2010, sipas të cilit, Alket Hatija është dënuar për veprimtari kriminale në vitin 2002-2003 në shtetin italian dhe vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda është i njëjtë me vendimin 4526, datë 30.09.2015 të Gjykatës së Apelit të Milanos. Kjo është e shkruar dhe unë vendimin jua kam paraqitur që të gjithëve ju që ta keni përpara.

Prandaj, unë thosha që, deri në këto momente, në qoftë se ministrja do ta kishte lexuar, do të kishte reflektuar dhe do të mbante një qëndrim tjetër, për faktin se ne jemi të gjithë juristë këtu dhe dimë të vlerësojmë se çfarë vendimi është ky. Është një vendim i cili është marrë nga një Gjykatë e Shkallës së Parë Durrës. Është një gjyqtar tjetër që është në detyrë. Pra në rast se do të ecim sipas shkeljes që ka paraqitur Kryeinspektorja, e cila thotë që unë kam diskredituar rëndë figurën e gjyqtarit, i bie që edhe gjyqtari i cili ka gjykuar...

Të lutem, nuk e kam në sensin...

Nuk është se ka bërë gabim. Por në rastin konkret nuk jemi përpara një diskreditimi të figurës së gjyqtarit dhe ai gjyqtar ka vendosur drejt. Se po të lexoni vendimin me vëmendje do shikoni se ai ka vajtur dhe ka verifikuar të gjithë dokumentacionin që ndodhet tek Krimet e Rënda.

E dyta, them përse në rastin konkret vendimi im është i drejtë.

E para, ka dy elementë kryesor që ka ngritur Inspektorati dhe Ministria. Elementi i parë është që unë kam vepruar në kundërshtim me praktikën time dhe me praktikën që është në këto raste. Gjë që s'është e vërtetë. E para, rastet tek ne nuk janë të njëjta, për faktin sepse një çështje nuk i ngjan çështjes tjetër dhe, së dyti, që unë nuk kam interpretuar saktë provat të cilat ndodhen në dosje.

Në materialin që ju kam paraqitur, ju them që, në rastin konkret, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës është paraqitur vetëm një kërkesë nga Interpol Roma për ekstradimin e shtetasit Alket Hatija, ndërsa nga ana e këtij shtetasi u paraqit përpara gjykatës vendimi nr. 10 i vitit 2010 të Gjykatës së Krimeve të Rënda ashtu si

edhe vendimi nr. 93 i vitit 2011 i Gjykatës Kushtetuese, i cili përcaktonte saktë se shtetasi Alket Hatija gjykohej njëkohësisht paralelisht si nga Gjykata e Krimeve të Rënda në Shqipëri, ashtu edhe nga Gjykata Milanos, dhe nuk mund ta lironte për faktin sepse akoma nuk ishte dhënë një vendim nga Gjykata e Milanos, i cili është dhënë në 2010, 2015, pasi dihet se në përgjithësi, gjykatat italiane japin vendimet e tyre me shumë vonesë në raport me gjykatat shqiptare.

Zonja ministre dhe Kryeinspektorja e bazon shkarkimin tim tek nen 38 i ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë” të vitit 2009, sipas të cilit, të dy, si Kryeinspektorja dhe juristët e ministrisë nuk e citojnë të plotë këtë nen. Pra, kanë cituar vetëm gjysmën e nenit, në rastin konkret, në mënyrë të qëllimtë nuk thuhet përmbajtja e plotë e nenit, të cilin unë po e them gjysmën, nga të cilën si Kryeinspektorja edhe ministra nuk e përmendin në materialin e tyre. Dhe konkretisht, pjesa e parë është që Zyra e Interpolit, me marrjen e një urdhri ndërkombëtar arresti nga një shtet i huaj, ia përcjell Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë, brenda 5 ditëve ia përcjell Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurori i Përgjithshëm, brenda 5 ditëve ia përcjell prokurorisë përkatëse ku banon shtetasi i cili duhet të ekstradohet. Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet gjykatës kompetente, për procedimin penal, paraqet kërkesë pranë kësaj gjykate. Deri këtu, ky nen është i cituar si nga Kryeinspektorja ashtu edhe nga ministrja.

Unë po lexoj pjesën të cilën këta qëllimisht nuk e kanë përmendur në materialin e tyre. Konkretisht: “4) Prokurori i Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e urdhrit ndërkombëtar prej Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore: a) verifikon gjeneralitetet e sakta të shtetasit shqiptar të kërkuar, duke përfshirë edhe shtetësinë e tij; b) merr të dhëna për vendndodhjen e saktë të shtetasit shqiptar të kërkuar; c) verifikon nëse shtetasi shqiptar është i dënuar me vendim penal me burgim të formës së prerë nga autoritetet gjyqësore vendase;... .” Pra në rastin konkret, prokurori i çështjes nuk është interesuar fare nëse ky shtetas ka patur ndonjë vendim gjyqësor penal shqiptar, që të ishte gjykuar për këtë çështje. Prandaj unë them që qëllimisht kjo pjesë e dispozitës nuk citohet në përmbajtjen e materialit që është kundër meje. Bile, verifikon edhe një fakt

tjetër, që është caktuar një masë sigurimi shtrënguese, -thotë, -për efekte të një procedimi penal nga autoritetet gjyqësore vendase. Ka edhe një element tjetër, për masat e sigurimit.

Ajo që thosha unë në këtë është fakti se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, kur ka paraqitur kërkesën për ekstradim të shtetasit në 24 shtator 2017, në pjesën që thotë, lidhur me ekstradimin, -po e citoj pjesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila thotë që: Të paktën në 15 episode, bazuar në përgjimin e fakteve procedurale të grumbulluara e të sjella në rrugë ligjore nga autoritetet e drejtësisë të policisë italiane në Shqipëri, shtetasi Alket Hatija rezulton të jetë dënuar nga gjykata shqiptare. Pra, vetë prokurori, në kërkesën për ekstradim që është bërë më datën 24 shtator 2017 e pranon që kemi të bëjmë që vendimi i gjykatës shqiptare, i cili ai e paraqiti përpara gjykatës, në 15 episode është i njëjtë. Atëherë, si mundet që ky prokuror të paraqitet dhe të cenojë në mënyrë flagrante interesat e një shtetasi shqiptar?

Gjykata ka për detyrë që, në procesin e ekstradimit, të verifikojë pikërisht nëse cenohen interesat e këtij shtetasi shqiptar. Pra, krahas faktit që ne duhet të ekstradojmë shtetas të cilët kanë kryer krime në shtetet e huaja, por në rastin konkret detyra jonë është që të mbrojmë edhe interesat e shtetasve shqiptarë për të cilët janë dënuar nga gjykatat shqiptare. Dhe për këtë, prokurori nuk e ka bërë detyrën. Në qoftë se unë isha si gjyqtar, unë s'mund ta anashkaloja dhe të thosha që ky shtetas nuk është dënuar nga gjykatat shqiptare. Dhe fakti doli që, pikërisht siç veprova unë në 11 korrik të 2017, në 5 mars të 2018 gjykata tjetër që gjykoi lidhur me ekstradimin arriti në të njëjtin konkluzion që arrita edhe unë.

Ilir Meta: Dakord! Dakord! Se po përsërisni të njëjtat gjëra.

Petra Çuri: Jo! Ishin në këtë aspekt.

Ilir Meta: Po pra. Prapë aty u kthjem.

Petra Çuri: Tani, kisha edhe diçka tjetër për sa i përket faktit, pa e përmendur, është vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ - më duket se e paraqiti kolegu përpara meje – është me numër 2, datë 28.05, lidhur me gjyqtaren Lindita Hoxha, në të cilin, Kolegji Administrativ ka arritur një definicion për sa i përket se cilat janë ato fakte të cilat mund të bëjnë gjyqtarin të diskreditojë figurën e tij. Dhe thotë: “Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i tërheq vëmendjen KLD-së se nuk është në misionin e

këtij organi kushtetues për të vlerësuar bazueshmërinë në ligje e në prova të vendimeve gjyqësore, qofshin këto të formës së prerë ose jo. Si një organ që procedon disiplinarisht gjyqtarët, KLD mund të vlerësojë vetëm aspekte formale të punës së një gjyqtari. Dhe në kllapa thotë, -si respektimi i solemnitetit në gjykim, etikës pas dhe gjatë punës...

Por kjo që doja të thosha unë është fakti dhe që është shumë e rëndësishme për këtë moment, unë them që në rastin konkret ka patur një pamjaftueshmëri juridike të inspektorese që ka ardhur sepse inspektorja ka qenë vetë në këtë çështje në Gjykatën e Lartë, Marsela Pepi, e cila ka mbrojtur këtë çështje të KLD-së dhe për rrjedhojë, kjo inspektore nuk mund të fillonte një procedim disiplinor ndaj meje kur e kishte të qartë vendimin e gjykatës i cili ishte e prillit të 2017.

Dhe e fundit që kisha unë, kisha një gjë tjetër lidhur me faktin që, ligji i ri 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 100 të tij, përcakton parimet e procedimit disiplinor. Këtë e kam edhe për zonjën ministre, për faktin se unë jam 62 vjeç dhe gjatë gjithë jetës time kam qenë një gjyqtar i rregullt dhe kam qenë jurist i rregullt në marrëdhëniet në të gjitha aspektet. Por nuk mundet që të shkelen parimet në mënyrë kaq flagrante dhe po them, unë gjyqin e bëra në datën 11 korrik. Në datën 18 korrik, në gjykatë kanë ardhur dy inspektorë të KLD-së. Por unë ardhjen e inspektorëve e mora vesh nga televizioni. Nuk e mora vesh vetëm nga ata që erdhën atje. Pra në rastin konkret, të gjitha televizionet e dhanë që unë po shqyrtohesha nga KLD-ja. E para, në rastin konkret u shkel parimi bazë që ka atje, parimi i prezumimit të pafajësisë, unë nuk isha fajtor deri në atë moment, dhe parimi i pavarësisë së gjykatës. Nuk mundet që të vijnë inspektorët dhe çdo njoftim që bëhet lidhur me një gjyqtar të publikohet dhe të jepen në televizione. Kjo për mua është në mënyrë kategorike.

Unë do thosha dhe do sugjeroja edhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, edhe procesverbalet e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk mund të publikohen sepse kanë të bëjnë me një parim tjetër më të rëndësishëm që është parimi i konfidencialitetit, i cili është në germën /f/ në mos gabohem, sipas të cilit gjyqtarit nuk mundet t'i nxirren fakte dhe prova sepse unë punoj me kriminelë, unë dënoj kriminelë në praktikën time të përditshme dhe si mundet unë të dalë përpara kur vetë avokatët më

thonë “ik ore, se ti je i ndjekur...”. Prandaj unë nuk mund të punoj në këto kushte. Prandaj edhe ministrja nuk mund ta nxirrte në faqen e saj të Ministrisë së Drejtësisë që kishte propozuar për mua largimin nga puna, për faktin sepse deri në momentin që unë gjykohej, unë prezumohem i pafajshëm, sepse kam të njëjtat parime si parimet që ka i pandehuri në gjyq, që i ka vendosur pikërisht, në rastin konkret, kjo mazhorancë me ligjin 96/2016 dhe në rastin konkret, në rastin tim janë cenuar në mënyrën më flagrante këto parime.

Ilir Meta: Faleminderit atëherë!

Petra Çuri: Faleminderit edhe ju që më dëgjuat!

Ilir Meta: Ka dikush pyetje nga anëtarët e KLD-së?

Po, Bruna!

Brunilda Kadi: Një pyetje në lidhje me çështjen, pavarësisht pjesës procedurale dhe asaj që arsyetuat. Ju keni vlerësuar që nuk ka pasur vend për ekstradim tek çështja.

Petra Çuri: Jo, nuk kam thënë këtë.

Brunilda Kadi: Ideja juaj domethënë, në vendimmarrje, është që meqenëse ky person për këtë vepër është dënuar një herë, nuk ka vend për ekstradim dhe për masë. Pyetja është, në qoftë se nuk kishte vend për masë, ju pse keni dhënë masën detyrim për paraqitje?

Petra Çuri: Meqenëse zoti President më tha... po ju përgjigjem pyetjes.

Neni 495 i K.Pr.Penale i cili ka vendosur, e ka bazuar, -siç pretendon edhe Kryeinspektorja, -presumon që në rastin konkret, kur gjykata bindet e lë në burg ose në të kundërt, -thotë, -në të kundërt, lirinë e tij.

Sipas inspektorese që më ka kontrolluar, thuhet që gjykata nuk mund të merrte masa sigurimi të tjera, përveçse asaj të lirimimit. Kurse unë do të them që, në rastin konkret kjo është pamjaftueshmëri juridike e inspektorese që më ka kontrolluar, për faktin sepse në qoftë se unë vendos lirinë, kam të drejtë të vendos edhe masa të tjera sigurimi të cilat kanë të bëjnë me lirinë, e konkretisht: “detyrim paraqitje”, “detyrim për mosdalje jashtë shtetit”. Këto kanë të bëjnë me një person që është i lirë në rastin konkret. Por janë detyrime të kufizuara në lirinë e tij, derisa të përfundojë procesi i ekstradimit. Prandaj edhe unë e vendosa.

Edhe një fakt tjetër. Ajo thotë...

Brunilda Kadi: Të lutem, nuk ka nevojë për të shpjeguar sepse ne jemi të gjithë gjyqtarë këtu, pjesa më e madhe, dhe e dimë çfarë do me thënë të vësh masë. Tani, kur vendos të vësh masë, në fillim bindesh që ka vend për masë, ndërsa lloji i masës, të gjithë e dimë, ka lidhje pastaj me rrezikshmërinë shoqërore. Tani, besoj se rrezikshmëria shoqërore në këtë rast... Prandaj edhe është bërë publik rasti, -apo jo? Prandaj doli edhe në media, që u lirua filani X Y, sepse mendohesh që ishte rrezikshmëria shumë e lartë dhe rrezikshmëria shoqërore, tek vendosja e llojit të masave, dhe besoj që e kemi të qartë të gjithë ne gjyqtarët dhe prokurorët. Thjesht për këtë ishte ideja e pyetjes. Faleminderit!

Petra Çuri: Në vijim të atij argumenti që thatë, se e mora vesh se ku doni të dilni, po ju jap edhe unë një argument tjetër, sepse nga ana e inspektore thuhet që unë kam vepruar në kundërshtim me praktikën time dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore dhe po ju them dhe po ju sqaroj. Përpara jush ju kam vënë dy vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me dy persona të cilët janë gjykuar identik siç kam gjykuar unë Alket Hatinë dhe është një A.Plaku (mos t'i them emrat) dhe është një G.Aleksi. Të dy këto çështje janë gjykuar në tetor të 2017, pra dy muaj mbasi kam gjykuar unë. Në të dyja rastet Prokuroria ka ardhur me "arrest në burg". Por si rezultat i presionit të mbrojtjes, për të parin i cili ishte kryetar i një organizate mjaft të madhe dhe që është për 7 vepra penale dhe që përfshin krijimin e organizatës kriminale, rrëmbim personi, shfrytëzim prostitucioni, dhe si përfundim, gjykata... Ja, një minutë, se dua të argumentoj të kundërtën e asaj që tha zonja. ...pra në fund, gjykata ta vendosur "detyrim paraqitje për të". Për të njëjtën gjë është edhe për personin Gëzim Aleksi i cili është dënuar për vrasje.

Gjin Gjoni: Një pyetje të lutem në lidhje me këtë vendimin për moslejimin e ekstradimit. Ku ndodhet aktualisht? Është në Gjykatën e Apelit apo është vendim i formës së prerë?

Petra Çuri: Jo! Ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit.

Gjin Gjoni: Faleminderit!

Gerd Hoxha: Vetëm një merak do të kisha unë i nderuar koleg, që kur vijmë këtu për të bërë mbrojtjen tonë, mos ta bëjmë duke thënë “në qoftë se unë jam kështu, ai do të jetë kështu”. Të këshilloj, pavarësisht se jam më i vogël...

Petra Çuri: Kërkoj falje. Edhe për shkak të rrëmbimit të momentin.

Gerd Hoxha: Ta mbaroj pak të lutem. Se unë jam tani njësoj si ty.

Petra Çuri: E kuptova se ku do të dilni.

Gerd Hoxha: Kur kam një gjë të tillë, unë do mbaj përgjegjësinë time. Nuk do them “nëse ma bëri kështu” për kolegët. Nuk është e mirë. Nuk na nderon. Duhet ta dish se ne jemi shumë pak dhe vijmë përditë bëjmë detyrën. Mos u tremb nga fjalët, as unë, as ti, nga askush tjetër. Në qoftë se bën punën... Faleminderit!

Etilda Gjonaj: Zoti gjyqtar, çfarë mase ju kishte propozuar ministri i Drejtësisë në atë kohë për ta mbajtur në kuadër të procedurave të ekstradimit që kërkoheshin të bëheshin.

Petra Çuri: Ministri i Drejtësisë nuk kishte asnjë kërkesë. Bile një nga arsyet që unë vendosa lirimin e tij, se mungonte kërkesë nga Ministria e Drejtësisë.

Etilda Gjonaj: Nuk e kishit ju mbajtjen e masës së sigurisë “arrest në burg”?

Petra Çuri: Jo, jo! S’kishte. Këtë po them, që një nga arsyet, po të lexoni edhe vendimin tim 11 korrik 2017 është fakti që nga Ministria e Drejtësisë nuk kishte fare kërkesë. Unë e ngre edhe në pretendimet e mia dhe them që, edhe në nenin 38 që ju citoni, e thotë që procedura fillon me Ministrinë e Drejtësisë si institucion, e cila paraqet kërkesë pranë Prokurorit të Përgjithshëm, -pra e filloni ju dhe që mungonte kjo kërkesë dhe, e dyta, përfundon me ju si ministre. Pra, procedura e ekstradimit përfundon me ministrin e Drejtësisë, i cili vendos ose jo të ekstradohet shtetasi, pavarësisht nëse gjykata ka vendosur të ekstradohet. Kjo e jep pikërisht Konventa Evropiane e... Konventa e Parisit e vitit 1957.

Ilir Meta: Po! Pyetje tjetër, s’kemi.

Mirë, ju falenderojmë.

Petra Çuri: Faleminderit edhe ju që më dëgjuat.

Etilda Gjonaj: Ministri i Drejtësisë bën propozimin në bazë të aktit të hetimit të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu që nuk mund të futet në

fakte, pavarësisht se është një çështje që i përfshin edhe Ministrinë e Drejtësisë për shkak të procedurave të ekstradimit dhe të marrëdhënies juridiksionale me jashtë. Por propozimin e bën mbi bazën e këtyre fakteve. Duke patur parasysh këtë raport, duke patur parasysh këto rezultate të ardhura nga inspektimi i kryer, ministri i Drejtësisë i qëndron të njëjtës masë të propozuar.

Ilir Meta: Ka dikush tjetër për t'u shprehur?

Po, Neritan!

Neritan Cena: Së pari, sikurse është thënë edhe nga aktet është ... iniciativë e policisë gjyqësore, një nga rastet, 495-sa parashikon që policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin në flagrancë të... në qoftë se ka të dhëna që kërkon, ka një urdhër ndërkombëtar për të cilin kërkojnë autoritetet e huaja. Më pas i dërgohet gjykatës, pikërisht gjykatës ku është bërë arrestimi, e cila vendos mbajtjen apo jo të masës së arrestit të kërkuar. Por me sa po kuptoj unë he me sa po rezulton, del që gjyqtari po thotë që kam refuzuar të jap masën e arrestit sepse më është paraqitur si pretendim fakti që ky është dënuar për tjetër veprë penale nga autoritetet shqiptare. Dhe një nga rastet kur refuzohet ekstradimi është pikërisht kur në qoftë se shtetasi shqiptar është dënuar për tjetër veprë penale në Republikën e Shqipërisë, pra që të përjashtohet ideja që mos të vuaj dy herë për të njëjtën veprë penale. Se çfarë kuptimi ka pastaj.

Tani, un po propozoj, meqenëse gjyqtari citoi një vendim që ka gjykuar në themel kërkesën e ekstradimit dhe thotë që, rezulton e vërtetë që ky është refuzuar sepse është dënuar nga autoritetet shqiptare, meqenëse ky nuk është vendim i formës së prerë, do propozoja ta pezullojmë shqyrtimin e çështjes së zotit Çuri deri në përfundim të zgjidhjes me vendim të formës së prerë të kërkesës bazë për ekstradim. Ky ishte një propozim procedural. Pastaj në qoftë se gjen mbështetje mirë. Në qoftë se nuk gjen, do vijojmë.

Gerd Hoxha: Më fal. Por as vendimi i atij zotërisë nuk ishte i formës së prerë. Pse e morëm ne? Edhe ai ishte një masë. Nuk është kjo logjikë tani ta pezullojmë e ta mbajmë tjetrin peng. Në qoftë se jemi këtu, kemi zgjedhur të vijmë në mbledhje pavarësisht çdo... këtu ka shumë njerëz që janë frikacakë dhe nuk vijnë në mbledhje. Ta them edhe këtë. Ne kemi zgjedhur të vijmë këtu në mbledhje dhe do përballemi me këtë. Kështu që s'kemi

pse të gjejmë artificia. Për procedurë, të gjithë këtu jemi aq të zgjuar sa të bëjmë... Mos ta lejmë tjetrin peng. O ta shkarkojmë, o mos ta shkarkojmë.

Gjin Gjoni: Edhe unë, bashkohem me qëndrimin e zotit Gerd Hoxha. Të them të drejtën, kur erdha në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë sot, kisha vendosur të mos flisja fare dhe të them të drejtën as për një masë penale nuk do flas. Do votoj në lidhje me këtë sepse nesër, pasnesër, pas një jave, pas dy javësh, shtypi do merret “Gjin Gjoni, Gjin Gjoni, Gjin Gjoni”, kështu që më mirë. Po them që nuk do shprehem, por them që në rastin konkret unë them që duhet të procedojmë. S’kemi arsye, sepse ligji e ka parashikuar “cenon figurën e gjyqtarit”, në rastin konkret. Në rast për një masë sigurimi e cenon, s’e cenon dhe të vendosim pse duhet të pezullohet dhe t’i mbajmë peng gjyqtarët. T’i shkarkojë vettingu.

Neritan Cena: Unë e lidha me shkakun për të cilin gjyqtari tha që unë kam refuzuar dhënien e masës. Sepse ka një vendim. Është dënuar për të njëjtën veprë penale nga autoritetet shqiptare dhe nuk ka sens. Edhe vetë ligji tek “Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë” e parashikon kur nuk lejohet ekstradimi i shtetasve shqiptarë nëse vërtetohet se ata janë dënuar për të njëjtën veprë penale nga autoritetet shqiptare.

Brunilda Kadi: Pse i dha masë?

Neritan Cena: Mjaftueshmëria apo pamjaftueshmëria është problem tjetër, nëse bëri gabim apo s’bëri gabim ai.

Ilir Meta: Neritan, dakord!

Atëherë, ministria i qëndron propozimit të parë?

Dakord!

Atëherë, hedhim në votim propozimin për “Shkarkim nga detyra” të gjyqtarit Petraq Çuri. Kush është dakord?

Ilir Meta, po!

Vazhdoni!

Gjin Gjoni: Kundër!

Vangjel Kosta: Pro!

Brunilda Kadi: Kundër dhe do ta shpjegoj votën.

Atëherë unë mendoj që nuk qëndrojnë ato argumentat e gjyqtarit, por jam kundër shkarkimit për arsytet që kam thënë në mbledhjet e mëparshme në lidhje me kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ilir Meta: Po!

Petrit Çomo: Kundër!

Ilir Meta: Po!

Ridvan Hado: Kundër!

Ilir Meta: Po!

Neritan Cena: Kundër!

Ilir Meta: Po!

Gerd Hoxha: Kundër!

Ilir Meta: Po!

Atëherë, nuk miratohet.

Ka propozim tjetër?

S'ka!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Ergys Selmani (masa disiplinore e propozuar “Shkarkim nga detyra”).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Etilda Gjonaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Zoti Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Ergys Selmani (masa disiplinore e propozuar “Shkarkim nga detyra”).

Ilir Meta: Vazhdojmë me pikën e tretë. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit Ergys Selmani, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Shkarkim nga detyra.

Të njoftohet të vijë.

(Përpara se të hyjë në sallë gjyqtari Ergys Selmani, anëtarët bëjnë një pauzë të shkurtër.)

Atëherë, vazhdojmë mbledhjen lidhur me çështjen e tretë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Ergys Selmani. Me kërkesë të ministrit të Drejtësisë.

Po! Zonja ministre do të thoni diçka?

Etilda Gjonaj: Atëherë, me shkresën e datës 02.02.2018, ministri i Drejtësisë i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozimin për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të gjyqtarit Ergys Selmani. Kërkesa bazohet në konstatimet e dala nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky hetim disiplinor është iniciuar nga materiali i dërguar në datën 07.12.2016 nga ish ministri i Drejtësisë Manjani, lidhur me ngjarjen e bërë publike në media, ku një shtetase u vra nga bashkëshorti i saj. Gjyqtari Selmani kishte gjykuar dy çështje gjyqësore për dhunën në familje ndaj shtetases në fjalë për këto gjykime, ministri i Drejtësisë kishte vlerësuar se ishin lejuar shkelje prej këtij gjyqtari.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin e këtij Këshilli, datë 15.09.2017 dhe me urdhrin e Kryeinspektores datë 25.09.2017, ka filluar hetimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Ergys Selmani dhe në përfundim nga konkluduar se ky gjyqtar ka kryer shkelje të rënda profesionale në llojin e masave ndaluese të parashikuara dhe mosarsyetim vendimi gjyqësor në dy çështjet objekt inspektimi, si dhe shkeljet e mësipërme përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor, referuar nenit 140, pika 2, shkronja /a/ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Me shkresën e datës 15.01.2018, Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i ka përcjellë ministrit të Drejtësisë raportin e hetimit disiplinor, pasi ka vlerësuar se sipas nenit 160, paragrafi i parë, ligji 96/2016, një ndër kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në këtë periudhë tranzitore është vendosja e masave disiplinore me propozim të ministrit të Drejtësisë, tashmë e unifikuar edhe me vendimmarrje të tjera që KLD ka bërë.

Lidhur me objektin e këtij inspektimi, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, më lejoni ta theksoj, ka nënvizuar se pavarësisht faktit se në thelb vendimmarrja i nënshtrorëj kontrolli gjyqësor nga gjykatat më të larta, në rastin konkret, inspektimi përfshinë të gjithë veprimtarinë gjyqësore të ushtruar nga gjyqtari Selmani, të dokumentuar në dy dosjet objekt inspektimi, në rastet kur kjo veprimtari plotëson elementët e parashikuar në nenin 140, paragrafi i dytë, pika /a/ të Kushtetutës, nuk ka asnjë lloj pengese, por përkundrazi, është detyrim i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë t'i hyjë kontrollit administrativ të kësaj veprimtarie, pa asnjë lloj kufizimi.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara përgjatë hetimit disiplinor të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë provohet se gjyqtari Selmani, në veprimtarinë e tij ka kryer shkelje të rënda profesionale, që konsistojnë në moszbatimin e një sërë dispozitave, si 1, 10, 17, 18, 19, 20, 23 të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Shkeljet e mësipërme të kryera nga gjyqtari Selmani kanë diskredituar pozitën dhe figurën e gjyqtarit, duke krijuar kështu premisa të ardhjes së një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm, që është pikërisht vrasja e shtetases në fjalë nga bashkëshorti i saj, për të cilën ajo kishte kërkuar mbrojtje në gjykatë.

Sa më sipër çmohet se për shkak të shkeljeve të rënda profesionale të gjyqtarit Selmani, referuar llojit të masave ndaluese të përcaktuara, duke lënë në të njëjtën banesë të dhunuarën me dhunuesin; shpalljen dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe atë të mbrojtjes në shkelje flagrante të afateve ligjore; mosvënien në dispozicion menjëherë të këtij vendimi paditëses, të paditurit dhe moskomunikimi nga administrata gjyqësore të këtij vendimi, për shkak të mosarsyetimit nga ana e gjyqtarit Selmani subjekteve zbatuese, sikurse ishte Komisariati i Policisë Fier, Zyra e Përmbarrimit, Bashkia Fier, ka shërbyer si premisë për krijimin e kushteve, pra për ardhjen e pasojës ekstreme që ka ardhur në rastin konkret, ajo e vrasjes së shtetases nga bashkëshorti i saj.

Në interpretim të dispozitës, të nenit 140, paragrafi i parë, në vështrim të nenit 115 të ligjit 96/2016 dhe duke patur në vëmendje zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34, 10.04.2017, vlerësohet se jemi përpara rastit kur duhet të gjejë zbatim

neni 140, paragrafi i dytë, germa /a/ e Kushtetutës, pasi gjyqtari Selmani ka kryer shkelje disiplinore që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit në sistemin e drejtësisë në tërësi, duke sjellë kështu pasojën e pazëvendësueshme.

Sa më sipër, bazuar edhe në nenin 160, pika 1, germa /c/ të ligjit 96/2016, ministri i Drejtësisë ka vlerësuar se deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në interpretim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, ka kompetencën ligjore që t'i kërkojë Këshillit të Lartë të Drejtësisë të vendosë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për gjyqtarin Ergys Selmani.

Prandaj, ministri i Drejtësisë i propozon këtij Këshilli vendosjen e masës disiplinore për gjyqtarin Selmani. Faleminderit!

Ilir Meta: Atëherë, zoti gjyqtar, në mënyrë sa më koncize të lutem.

Ergys Selmani: Atëherë, përpara se të filloj me argumentat e mia mbrojtëse, kam dy kërkesa procedurale. Kërkesa e parë është që kërkoj nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të marrin kërkesën procedurale për parashkrimin e plotësuar të hetimit apo procedimit tim disiplinor në lidhje me shkeljen e pretenduar dhe të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë. Rezulton se sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 7963, datë 05.12.2016 është urdhëruar nisja dhe verifikimi i procedurave të urdhrit të mbrojtjes. Sipas ligjit organik që ka funksionuar në atë kohë në Ministrinë e Drejtësisë është bërë një inspektim nga inspektorët e përcaktuar. Kërkesën më të detajuar e keni për secilin nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë me shkrim, megjithatë, unë po e bëj më të përmbledhur.

Nga themelimi i nenit 6, titulli “Fusha e veprimtarisë”, pika 9 e tij, i ndryshuar ky ligj me fletoren zyrtare 34, datë 13 prill 2012, ka qenë formuluar si poshtë: 9) Ministria e Drejtësisë kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit. Lidhëza ‘dhe’ e përdorur nga ligjbërësi, lidh gjymtyrët e dy fjalive në drejtim të një veprimi të njëkohshëm dhe në mënyrë logjike vjen përfundimi se përderisa inspektimi u krye nga organi përkatës, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë duhet të paraqiste edhe kërkesën për procedim disiplinor. Rezulton se më pas kjo kompetencë e ministrit të Drejtësisë,... me ligjin organik të gjyqësorit, ligjin 96/2016 u ndryshua dhe Ministria e Drejtësisë paraqiste vetëm kërkesën

e motivuar për inspektim, pra nuk kishte të drejtë të kryente inspektim. Ky fakt del edhe nga përmbajtja e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë por edhe nga vetë raporti i Ministrisë së Drejtësisë, ku po përmendim në mënyrë eksplicite tekstin e këtij raporti (fq. nr. 3, titulli “Analiza e rastit”), ku thuhet: Referuar kësaj dispozite tranzitore, nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë vlerësohet se ministri i Drejtësisë ka kompetencë tranzitore për ushtrimin e së drejtës së verifikimit të rasteve që përbëjnë shkelje disiplinore. Në mënyrë të qartë u la detyrë që të hartohet relacioni sipas ligjit 96/2016 dhe kjo shkresë është marrë më datë 27.12.2016. Nga data 27.12.2016 deri në momentin që u nxor urdhri i Kryeinspektores nr. 1, datë 25.09.2015 (*viti i përmendur nga gjyqtari është lapsus, pasi është 25.09.2017*), sipas meje, janë parashkuara afatet e përcaktuara në mënyrë ligjore nga nenet 172, pika 1 dhe 2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si në drejtim të hetimit, por edhe të procedimit disiplinor, pra që lidhen me afatin 3-mujor dhe 6-mujor.

Gjithashtu, jam i detyruar të citoj edhe përmbajtjen e këtij ligji... i cili detajon në mënyrë të detajuar afatet përkatëse të hetimit dhe të procedimit përkatës administrativ. Këtë fakt gjithashtu më duhet ta evidentoj edhe në mbledhjen përkatëse të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në datën 15.09.2017, ku vetë ministrja e Drejtësisë, zonja Etilda Gjonaj ka thënë, ashtu siç tha edhe Kryeinspektorja, nga procesverbali i zbardhur nga kompjuteri dhe i detajuar në uebsajtin (website-in) e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, thuhet se: “...Në fakt, Ministria e Drejtësisë nuk ka pasur kompetenca inspektimi dhe vuajtja që ka pasur ka qenë gjithmonë deri para hyrjes në fuqi të ligjit “Për statusin”, ka qenë gjithmonë mbivendosja. Megjithatë, ajo çfarë unë shikoj sot, është që raporti që ka dërguar ministri Ylli Manjani në atë kohë është që mund ta konsiderojmë më tepër si një raport inspektimi...”. Pra edhe nga vetë fjala e ministres del qartë fakti që kemi të bëjmë me një raport inspektimi.

Gjithashtu, kam një kërkesë procedurale, që në lidhje me pretendimet e mia në favor të argumentimeve të mia mbrojtëse, kërkoj të pyetet me cilësinë e dëshmitarit shtetasi Kastriot Dyrmishi, anëtar i Dhomës së Avokatisë Fier, i cili do të japë të dhëna në lidhje me faktin në fjalë.

Tani, në mënyrë më të detajuar, në qoftë se do të vazhdojmë, në qoftë se do t'i jepet zgjidhje ka apo s'ka të plotësuar afat parashkrimi, atëherë duhet të kalojë në përmbajtjen e themelit.

Ilir Meta: Dakord! Mund të dilni përjashta që të mund të shprehemi për kërkesën e parë?

Ergys Selmani: Po, patjetër!

(Gjyqtari Selmani largohet momentalisht nga salla e mbledhjes.)

Ilir Meta: Çfarë mendimi keni për këtë kërkesë?

Më fal, zonja ministre! Sepse rasti sipas vlerësimeve që ka bërë Inspektorati, e ngarkon me përgjegjësi mjaft të rëndë për shkak edhe të pasojës që ka ndodhur. Është një fenomen ky. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një rast të veçantë. Unë kam përshtypjen që çdo lloj solidariteti, në rastin që edhe dy-tre elementë nga këto pretendime të Inspektoratit janë të provuara, është i pavlerë dhe e dëmton mendoj imazhin e gjithë sistemit.

Etilda Gjonaj: Vetëm për saktësuar që pavarësisht se çfarë ministri i mëparshëm Manjani ka kryer, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer inspektimin me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që është i datës 15.09.2017 dhe ka filluar hetimin disiplinor ndaj Gjykatës së Rrethit... Selmani. Kështu që nuk është për faktin që ministri i Drejtësisë, pavarësisht çfarë inspektimesh ka kryer, pavarësisht që ka hyrë në fuqi ligji i ri i statusit 96/2016, përsëri inspektimi dhe ajo mbi bazën e të cilave ministri i Drejtësisë sot ka bërë propozimin për masën ndaj gjyqtarit, është në kuadër të raportit të inspektimit që ka kryer Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Domethënë për të qenë të qartë në pjesën çfarë u tha nga gjyqtari.

Ilir Meta: Kush është dakord me kërkesën e paraqitur nga gjyqtari?

Kush është kundër?

Po!

(Rihyn në sallë gjyqtari Ergys Selmani.)

Dy kërkesat nuk u morën parasysh, kështu që mund të vazhdoni me thelbin e qëndrimit tuaj, ju lutem.

Më fal, ka mundësi të të ndërpres?

Vetëm për korrektësi. Kemi këto pretendime: -Mosnjohim i rregullt i aktit të urdhrat të mbrojtjes; -Mosshpallje e arsytuar dhe zbardhje të urdhrat të mbrojtjes brenda afatit të kërkuar; -Mosnjohim brenda afatit të kërkuar nga ligji të institucioneve shtetërore të lidhura me çështjen, si Policia e Shtetit, Bashkia, Zyra Vendore, etj.

Mund të japësh përgjigje për këto? Se po të fillojmë...

Dakord!

Ergys Selmani: Dakord!

Atëherë, hidhemi tek pyetja më e mprehtë. Atëherë, si e provoni faktin që ... mori kopje të vendimit?

Atëherë, sipas nenit 19, pika 4 e ligjit 9669/2016 parashikohet se për efekt emergjence të këtyre rasteve, dy kopje origjinale të këtij vendimi, jepen dorazi të dhunuarës, në mënyrë që kjo, një kopje ta mbajë vetë dhe një kopje tjetër ia vë në dispozicion policisë në momentin që i paraqitet nevoja. Originaliteti i shkresave rezulton se është vendosur me vulën e masave të sigurisë. Sipas kësaj norme lejuese ka vepruar shumica e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Fakti i disponimit të këtyre vendimeve do të vërtetohet, sepse prandaj kërkova edhe dëshminë e avokatit Kastriot Dyrmishi, i cili më ka dëshmuar se i është paraqitur me kopje të vendimit në dorë e dhunuara, ku i ka bërë të ditur se donte që të niste procedurat e zgjidhjes së martesës. Në këtë moment procedural i është bërë e ditur nga ky avokat sepse kishte kërkuar kot masa sigurie dhe i kishte thënë ajo që unë problemin e kam për shkaqe ekonomike me bashkëshortin e saj.

Në lidhje me dokumentacionin që është mbajtur në lidhje me dorëzimin e tyre. Tani, veprimtaria e gjykatës, në raport me personelin e saj ndihmës është mbështetur deri në këtë moment në parimin e mirëbesimit, bonafides dhe transparencës deri në këto momente. Por më duhet t'ju theksoj se deri në këto momente, para kësaj gjykate, nuk kishte një regjistër të detajuar për vendimet e natyrës së lëshimit të urdhrave të mbrojtjes, pra praktikisht në këtë kohë, fakti i depozitimit të urdhrave të mbrojtjes dhe konkretisht vendimet e ndërmjetme dhe përfundimtare dhe procedura e ankimit të tyre, vërtetoheshin vetëm me vërtetimin e njëanshëm të kryesekretares.

Nisur nga kjo ngjarje sensitive por edhe nga ngjarje të tjera të rënda siç ishte edhe vrasja e gjyqtares Fildez Hafizi, KLD ka vendosur që të mbahet një regjistër i veçantë. Ky fakt përmendet qartazi edhe si risi në raportin tematik të KLD-së të vitit 2018, për rastet e dhunës në familje. Në lidhje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ju citoj pjesë nga ky raport, ku thuhet: Është nxjerrë nga urdhri i kryetarit të gjykatës për përmirësimin e regjistrave me qëllimin e evidentimit veçmas të çështjeve gjyqësore që lidhen me rastet e dhunës në familje. Në këto regjistra janë pasqyruar tashmë të dhëna të përgjithshme për çështjen gjyqësore, të dhëna të posaçme me palët, si recidivizmi, moshja e palëve, etj., etj.

Po në vitin 2018...

Ilir Meta: Më fal, se këto janë shumë. S'e ke bezdi...!

Vlerësimi i parë për këtë kërkesë ndaj jush ka të bëjë me mosnjoftimin e rregullt të aktit të urdhrit të mbrojtjes. Ndalojmë këtu. Ti pretendon...

Ergys Selmani: Atëherë, në lidhje me mosnjoftimin...

Ilir Meta: Si përgjigjesh ti shkurt për këtë.

Ergys Selmani: Në momentin që e dhunuara, e ndjera, në rastin në fjalë mori dy kopje të vendimit, një kopje, në gjykimin tim ia vuri në dispozicion organeve të policisë, pasi në procesverbalin e deklarimeve të inspektorit të zonës Lavdosh Plaka, i cili merreshë me monitorimin e rastit në fjalë...

Ilir Meta: Domethënë, ti ia ke bërë njoftimin e rregullt?

Ergys Selmani: Ia kam bërë. Dhe ia ka dhënë dorazi. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin...

Ilir Meta: Dakord! Kjo është përgjigja juaj.

Dakord, dakord! Kjo është përgjigja juaj.

Ergys Selmani: Të lutem. Ja, një sekondë. Tani, gjithmonë gjykata mori përgjegjësitë e veta që në momentin e parë. Organet ligj-zbatuese kanë fshehur kokën deri kësaj dite, si frikacakë të rëndomtë. Të lutem!

Ilir Meta: Më fal. Po merremi një për një.

Ergys Selmani: Ja, një sekondë, të lutem zoti President.

Tani, në lidhje me mënyrën e njoftimit, kërkohet gjithmonë origjinali i dëftesës, por Kodi i Procedurës Civile, në bazë të nenit 144 të K.Pr.C. ka edhe mënyra të tjera

njoftimi, çka do të thotë që ato bëhen edhe me mjete të komunikimit elektronik, bëhen nëpërmjet telefonit. Policia gjyqësore, në momentin që mori urdhrin e mbrojtjes kishte në dispozicion dy numra telefoni. Gjithashtu, ishte parashikuar...

Ilir Meta: Më fal. Kam një pyetje tjetër.

Ti ia ke bërë njoftimin brenda afatit të kërkuar nga ligji institucioneve shtetërore, përveçse ia ke bërë personit?

Ergys Selmani: Tani, të themi këtë. Pavarësisht se unë nuk kam detyrim sepse gjyqtari nuk merret me njoftimin e vendimeve të ndërmjetme apo... është personeli administrativ. Unë kam marrë përgjegjësitë e mia dhe ia kam njoftuar këtë dorazi kërkuar, në momentin që kam dhënë vendimin. Personeli tjetër ndihmës, kryesekretaria gjyqësore duhet të merrte masat e saj për komunikimin e vendimit të ndërmjetëm që është detyrë e saj puro organike sipas ligjit për funksionimin e saj, si dhe në lidhje me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 1830 "komunikimi i vendimeve të ndërmjetme", të cilat këto janë vendime të ndërmjetme.

Ilir Meta: Dakord! Ky është qëndrimi juaj për këtë.

Pyetja tjetër: Ju e keni shpallur të arsyetuar dhe keni zbardhur urdhrin brenda afatit të kërkuar?

Ergys Selmani: Po! Atëherë, me vendimin e fazës së parë, që është lëshimi i menjëhershëm i urdhrit të mbrojtjes, është i arsyetuar sepse po të nisemi, si ka mundësi që pala e paditur bëri ankim ndaj këtij vendimi? bëri ankim. Pra ishte i zbardhur vendimi. Dhe ai është depozituar brenda afatit 5-ditor, po të jemi korrekt. Sepse dispozitat e K.Pr.C. prevalojnë ndaj çdo akti tjetër nënligjor. Unë jam në rregull si me afatin 5-ditor edhe me vendimin përfundimtar të cilin e kam dorëzuar sipas nenit 308 të K.Pr....

Ilir Meta: Dakord!

Ergys Selmani: Të lutem! Se duhet ta sqaroj. ...brenda 10 ditëve në kryesekretari.

Ilir Meta: Dakord!

I dhatë përgjigjet për tre çështjet kryesore.

Tani, t'ua lejmë radhën të pyesin në qoftë se kanë...? Dihet domethënë se kush janë pretendimet ndaj jush. Ju dhatë përgjigjet për këto tre çështje. Apo jo?! Të tjerat janë histori pa vlerë për vendimmarrjen tonë.

Ergys Selmani: Tani, se është një kohë shumë e shkurtër dhe ne jemi në tension dhe nuk i përmbledhim dot të gjitha.

Atëherë, po ju vë edhe në dijeni sepse edhe një shkresë që i është drejtuar Zyrës së Përmbartimore në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi. Më vjen keq shumë dhe në këtë mbledhje të nderuar, që përgjegjësitë e Zyrës së Përmbartimit e cila sipas nenit 144/a të K.Pr.C. ka edhe ajo kompetenca njoftimi njësoj si personeli i administratës. Nuk përmendet fare. Kështu që unë mendoj që mua më duket sikur anashkalojnë tërë përgjegjësitë dhe orientohen vetëm te gjykata. Gjykata nuk ka përgjegjësi fare.

Ilir Meta: Më fal. Ju dhatë përgjigjen tuaj për pretendimet ndaj jush. Tre janë pretendimet ndaj jush. Ju dhatë përgjigjet tuaja. Mos të merremi me Zyrën Përmbartimore dhe me të tjerët. Kanë përgjegjësitë e tyre. Të lutem!

Kush ka pyetje tani për këto tre çështje? Sepse flasim për thelbin e çështjes. Nuk po flasim këtu për të bërë një vlerësim të gjyqtarit për gjithë këtë kohë.

Po, Neritan!

Neritan Cena: Atëherë, i nderuar zoti gjyqtar! Referuar materialit, duke lënë pjesën e zbardhjes apo dorëzimit, theksohet që edhe ju, tek pjesa e arsytimit thuhet që personi paraqet rrezikshmëri dhe përfundimisht ju arrini në përfundimin që duhet 2m distanca. Distanca 2m, ndërkohë që në arsyetim pranoni që personi paraqiste rrezikshmëri. E dhunuara e kishte dëshmuar një fakt të tillë. Kush ishin ato arsye për të cilat duhej që të vendosje këtë distancë 2m, ndërkohë që ka edhe një pretendim që mund të jepej 50m.

Ergys Selmani: Atëherë, pyetja është shumë e saktë. Atëherë, kjo gjendet në vetë organizimin dhe dispozitat përkatëse të ligjit për masat e dhunës në familje. Vetë neni 10, pika /a/ ka parashikuar që vetë e dhunuara mund të parashikojë që në një dhomë në këtë banesë mund ta përdorë vetë i dhunuari një pjesë të banesës dhe ky kërkim nuk është se u ngrit nga gjykata. Ju lutem, më dëgjoni me shumë vëmendje. Ky u ngrit nga oficeri i policisë gjyqësore i cili asistoi në ngritjen e padisë dhe padia është e qartë, ndodhet përpara jush. Ajo thotë 50m larg dhe në një dhomë njëri, në një dhomë tjetri. Në gjykatë ka kriteret logjike, ka kriteret arsytuese. Ai nuk ishte ndonjë pasanik që kishte shtëpi me 140m². Ai kishte një dhomë e një kuzhinë, kështu që në një dhomë njëri, në një dhomë

tjetri. Më thoni, ku do qëndrojnë 50m larg ata? Kështu që gjykata vuri në lojë arsyetimin. Tha, -2m larg. Dhe për më tepër që vetë në padinë e saj, në planin e masave që kërkohet të merret nga ana e policisë gjyqësore, thuhet që do t'i vihet në dispozicion një oficer i policisë gjyqësore. Më pas, ky oficer i policisë gjyqësore, jo pa qëllim nuk ka vendosur emrin e tij, për të vënë në vështirësi vendimmarrjen. Po ashtu, edhe gjatë seancës gjyqësore, pavarësisht se përpiqet gjykata gjithmonë të anatemohet, unë e ndjeja si vështirësi këtë dhe i them, -“zonjë, si në një shtëpi?”, “si mundet të rrini juve, kur keni këto probleme?” – ajo gjithmonë evidentonte problemin që kam probleme në lidhje me harxhimin e parave të kursyera në shtetin gjerman. Më duhet të theksoj se në qoftë se do të kishte problem analitik të tillë, edhe vetë shteti gjerman nuk do ta kishte kaluar këtë kaq lehtë. Ata kishin jetuar ilegalisht në shtetin gjerman dhe nuk kishin pasur probleme të tilla. Problemet e tyre kanë filluar për shkak të konsumimit të parave në shtetin shqiptar dhe – të lutem e fundit- vetë policia kështu ma ka paraqitur “mosmarrëveshje për shkaqe ekonomike, kursimeve të familjes/harxhimet”.

Ilir Meta: Kush ka pyetje tjetër?

Etilda Gjonaj: Zoti gjyqtar, keni dhënë vendime të tjera të këtij lloji, ku largësia, sidomos në rastet e dhunës në familje, të jenë 2m?

Ergys Selmani: Tani, në qoftë se do të futemi në rrjedhën logjike të vendimit, këtë duhet ta kërkojmë njëherë nga niveli jo i konsiderueshëm i policisë, i cili bën kërkime të tilla në gjykatë. Ju e dini shumë mirë që gjykata nuk mund të dalë jashtë disponimeve të palës paditëse dhe shprehet vetëm për atë që i kërkohet dhe për atë çka kërkohet në gjykim. Gjykata nuk mund të marrë rol aktiv dhe për më tepër është e dhimbshme që në rastin konkret, e ndjera nuk kishte as asistencë mbrojtjeje. Vetëm vonë, sipas ligjit “Për ndihmën juridike”, u fut me shumë kujdes asistencë mbrojtëse në lidhje me raste të tilla, pra të rasteve të dhunës në familje dhe për më tepër edhe sot e kësaj dite unë ndihem në vështirësi sepse ligji ka dalë por nuk kanë dalë aktet nënligjore dhe hyn në një kohë të caktuar.

Tani, unë po them këtë tjetrën.

Një sekondë. Këto janë rrjedhojë e të gjithave.

Duke parë që në pritshmëritë në lidhje me qendrat rehabilituese private dhe shtetërore në Qarkun e Fierit janë inekzistente. Atëherë, gjykata, duke ndjekur edhe një balancë në atë çfarë kërkonte vetë pala paditëse në gjykim, vendosi këtë. Ky vendim, nuk mund të them që ka qenë uniform me të gjitha vendimmarrjet e mia, por po të doni inspektoni edhe rastet e tjera të ngjashme pranë kësaj gjykate nga gjyqtarë të tjerë, të cilët nuk kanë sjellë këto pasoja. E dyta, sa i përket faktit, iu bëj me dijeni se vetë i dhunuari e ka zbatuar vullnetarisht vendimin gjyqësor dhe ka qenë i larguar nga banesa. Po t'i referoheni vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, në thënien e tij ai thotë “-më ka thërritur ime shoqe sepse kisha fëmijën sëmurë”. Tani, nuk mund t’ia hiqim ushtrimin e përgjegjësisë prindërore në të tilla raste. Dhe ka vajtur të nesërmen. Aty, me të vajtur në banesë, e dhunuara i kthehet në krahun tjetër: -“ku shkon ti?, “pse del jashtë banese, se kemi fëmijën sëmurë.”

Ilir Meta: Dakord!

Pyetje tjetër, kush ka?

Nuk ka!

Mirë atëherë, faleminderit për sqarimet.

Ergys Selmani: Faleminderit juve!

(Gjyqtari Ergys Selmani largohet nga salla e mbledhjes.)

Ilir Meta: Vazhdojmë atëherë!

Po, ministre!

Etilda Gjonaj: Detyrimin e ka gjyqtari për të zbardhur dhe për të zbardhur vendimin e arsyetuar dhe ta depozitojë në sekretari. Më pas, sekretaria, administrata bën njoftimet përkatëse tek institucionet përgjegjëse. Nga raporti i inspektimit të Inspektoratit na rezulton që asnjë nga institucionet përkatëse shtetërore nuk e ka pasur një vendim të tillë. Kështu që është përgjegjësi e gjyqtarit që nuk e ka zbardhur vendimin.

Ilir Meta: Domethënë ju jeni e bindur që nuk e ka zbardhur.

Etilda Gjonaj: Nga informacioni që ne na rezulton nga raporti i inspektimit të Inspektoratit, jepet fakti që nuk është zbardhur në kohë.

Ilir Meta: Juve Marsida, çfarë mendimi keni për këtë çështje?

Marsida Xhaferllari: Neve na ka rezultuar që janë këqyrur të dyja dosjet gjyqësore, dhe dosjet gjyqësore janë të listuara, kanë edhe inventarin e akteve dhe në të dyja këto dy dosje gjyqësore nuk ka pasur të listuar/të inventarizuar akte njoftimi. Gjyqtari pretendon që Zyrën e Përmbarrimit e ka njoftuar vetë personalisht, duke qenë edhe konfuz se thotë njëherë që unë e bëj vetë personalisht njoftimin sepse e kisha afër përmbarrimin, ndërkohë njoftimet e tjera s'janë detyrë e imja.

Ndërkohë, na ka rezultuar nga këqyrja e sistemit RIV, tek sistemi i menaxhimit të çështjeve që arsyetimi i vendimit është hedhur në datën 3 dhjetor (ditë e shtunë), pikërisht ditën që u bë publik vrasja e shtetas Liljana Ruka dhe ngjarja ka ndodhur në orët e drekës (rreth orës 15:00 dhe 16:00), ndërsa vendimi është mbyllur në orën 19:04 minuta, është i dokumentuar në sistem. Kemi marrë edhe dëshmitë e dëshmitares, të vetë sekretares së gjyqtarit, të kryesekretares gjyqësore dhe kemi arritur në konkluzionin që ka pas vonesë nga gjyqtari në arsyetimin e vendimit dhe rrjedhimisht edhe njoftimet kanë dështuar, nuk janë bërë. Është bërë një tentativë pastaj, të hënën, i është çuar policisë urdhri i mbrojtjes dhe ata e kanë shënuar “refuzojmë marrjen”, se e kanë marrë kështu si...

Ilir Meta: Okej!

Kam përshtypjen që është rast shumë flagrant dhe kemi të bëjmë me një fenomen, përveçse një rasti konkret mjaft tragjik.

Kështu që, ju zonja ministre, i qëndroni propozimit tuaj të parë mbas kësaj...?

Etilda Gjona: Po, i qëndroj propozimit për masën e “Shkarkimit nga detyra” të gjyqtarit Selmani.

Ilir Meta: Atëherë, fillojmë të shprehemi për këtë masë “Shkarkim nga detyra” të gjyqtarit Selmani?

Unë jam pro shkarkimit.

Vazhdojmë!

Gjin Gjoni: Kundër.

Vangjel Kosta: Pro.

Brunilda Kadi: Kundër.

Petrit Çomo: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Neritan Cena: Kundër.

Gerd Hoxha: Pro.

Ilir Meta: Nuk miratohet.

Më duket një vendim i pajustificueshëm.

Gjin Gjoni:... propozim tjetër, zoti President.

Të kalohet në masën tjetër, e cila është...

Është “Vërejtje publike”.

Ilir Meta: A shkon “Vërejtja publike” në këtë rast?

(Nuk ka regjistrim për këtë moment pasi mikrofonat kanë qenë të fikur.)

Etilda Gjonaj: Unë jam kundra, për shkak të gjithë shkeljeve të rënda që ka gjetur raporti i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe gjithë pasojën e rëndë që ka sjellë, jam kundra të një mase alternative për sa kohë që propozimi është për shkarkim.

Ilir Meta: Edhe unë jam...

(Miratohet masa e dytë “Vërejtje publike”. Mbyllja e kësaj pike nuk është mundur të regjistrohet, pasi mikrofonat në sallë kanë qenë të fikur.)

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Ahmet Jangulli (masa disiplinore e propozuar “shkarkim nga detyra”).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Ilir Meta</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Etilda Gjonaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Gjin Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Gerd Hoxha</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Petrit Çomo</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Zoti Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Ahmet Jangulli (masa disiplinore e propozuar “shkarkim nga detyra”).

(Kjo pikë e rendit të ditës u shty.)

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë

[Shqiptaria.com]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË
(Mbajtur, më 07.05.2018)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Ken Dhima (masa disiplinore e propozuar “Shkarkim nga detyra”).

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Ilir Meta.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 11:55 dhe mbaroi në orën 14:16.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Meta*** (kryetar)
2. ***Etilda Gjonaj*** (anëtare)
3. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
4. ***Vangjel Kosta*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Gerd Hoxha*** (anëtar)
7. ***Petrit Çomo*** (anëtare)
8. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. *Artan Broci, znj. Eneida Civici.*

Shënim 2: Zoti Haxhialushi nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Shënim 3: Zoti Zaganjori nuk merr pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
2. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
4. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
7. *Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë.*
8. *Besmir Beja, Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë.*
9. *Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit.*
10. *Bledar Dervishi, Këshilltar i Presidentit.*
11. *Eksperte e Misionit EURALIUS.*
12. *Ekspert i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Ken Dhima (masa disiplinore e propozuar “Shkarkim nga detyra”).

(Pika e 5-të e rendit të ditës fillon pa regjistrim, pasi mikrofonin ka qenë i fikur. Thërritet të hyjë në sallë gjyqtari Ken Dhima.)

Ilir Meta: Atëherë, fillojmë. Zonja ministre, do të thoshit ju diçka shkurtimisht?

Etilda Gjonaj: Me shkresën e datës 27.02.2018, ministri i Drejtësisë i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozimin për marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtarit Ken Dhima. Kërkesa bazohet në konstatimet e dala nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektorati i KLD-së. Inspektorati i KLD-së ka hetuar disiplinarisht veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit Dhima për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, në dorëzimin me donesh të 212 vendimeve gjyqësore në periudhën dhjetor 2016 – korrik 2017. Në përfundim të hetimit disiplinor, Inspektorati i KLD-së ka konkluduar se gjyqtari Dhima ka kryer shkelje të rënda profesionale në mosrespektim formal të ligjit duke arsyetuar me vonesë vendimet gjyqësore.

Shkeljet e mësipërme përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor referuar nenit 140, pika 2, shkronja /a/ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe duke mbajtur në konsideratë vendimmarrjen e unifikuar tashmë dhe interpretimin e nenit 140, pika 2, shkronja /a/ të Kushtetutës, ashtu si dhe ligji 96/2016, neni 160, pika 5, ku thuhet se deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm hetojnë shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të KLD-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Bazuar në procedurën dhe kriteret e pjesës 5 të dispozitës kalimtare të këtij ligji, ministri i Drejtësisë ka bërë propozimin, ka vlerësuar se deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në interpretim edhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, ka kompetencën për t’i propozuar KLD-së që të vendosë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Ken Dhima.

Për këtë arsye, si përfundim, ministri i Drejtësisë i propozon këtij Këshilli vendosjen e masës “Shkarkim nga detyra” për gjyqtarin e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Vlorë, zotit Dhima.

Ilir Meta: Atëherë, zoti gjyqtar, do t’ju lutesha, shkurtimisht, kush është qëndrimi juaj, në mënyrë që të bëjnë ndonjë pyetje pastaj kolegët për të kuptuar thelbin.

Ken Dhima: Faleminderit!

Atëherë, lidhur me kërkesën e ministres për shkarkim, unë e mora vesh nga portalet, të hënën e kaluar, në orën 05:⁰⁰ pasdite. Në Gjykatën Administrative Vlorë nuk ka të administruar... nuk është fare në protokoll – e kam këtu fletën e protokollit; i kam

këtu të gjitha provat për të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë – që unë kam marrë dijeni. Por megjithatë nuk ka problem.

Unë jam anëtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë që nga viti 2013, që u krijua vetëm me 2 gjyqtarë. Kam statistika këtu nga kryesekretaria. Në vitin 2013 për dy muaj kam dhënë 89 vendime. Në vitin 2014, 1003 vendime. Në vitin 2015, 946 vendime. Në vitin 2016, 1033 vendime. Në vitin 2017, 715 vendime. Këtu nuk llogariten mijëra vendime pranim ankimi dhe rekursi, që secila prej tyre do të paktën 15 minuta, mos të themi më shumë, sepse do të bësh verifikime; është vendim i formës së prerë; mund të lejohet ankim, s'lejohet ankim; është bërë ankimi në afat, etj., etj., etj. Pra kam dhënë 4000 dosje.

Përse nuk përmendet këtu as nga Kryeinspektorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, as nga ministrja e Drejtësisë, që 80% e gjykimeve unë i kam përfunduar për dy muaj. Në qoftë se do të gjendej një gjyqtar me ngarkesën time në Republikën e Shqipërisë, unë dorëzohet çelësat.

Nuk janë dorëzuar të gjithë dosjet me vonesë. I kam dhënë prioritet... e kam shkruar edhe...

Ilir Meta: Më fal, të bëj dy pyetje, që t'ju ndihmoj edhe juve, të ndihmoj edhe kolegët. E para, pretendimi ndaj jush është që janë dorëzuar 212 vendime gjyqësore përfundimtare, në shkelje të konsiderueshme të afatit. Ajo që kuptoj unë, që pretendoni, që kjo nuk ka ardhur për shkak të neglizhencës, nëse ky fakt është i vërtetë dhe ky numër është i vërtetë, por për shkak të ngarkesës shumë më të madhe që ju keni patur dhe pamundësisë, ndoshta nga koha fizike për të dorëzuar çdo gjë brenda afatit. Ky është thelbi? E para!

Domethënë, ky numër është i vërtetë? 212 vendime gjyqësore përfundimtare në shkelje të konsiderueshme të afatit?

Ken Dhima: Po mund të jetë. Se s'i kam hyrë asaj... sepse i di që i kam të gjithë dosjet me vonesë, sepse s'mundem.

Ilir Meta: Mirë, mirë! Dakord!

Për 2 vjet është kjo? Për 2016-2017 apo për 1 vit?

Ken Dhima: Ku pata kohë ta lexoj unë? Unë të martën mora vesh që... Nga televizioni, nga Birni... i mora vesh.

Ilir Meta: Dakord! Vazhdo!

Ken Dhima: Atëherë, i kam dhënë prioritet - i nderuar President dhe të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë – dorëzimit të dosjeve me palë të paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë dhe të degëve të tjera që kanë lodhur qytetarët për muaj e vite me radhë për një pension që nuk e gëzojnë për shkak të ankimeve në gjykatat më të larta. I kam dhënë prioritet fëmijëve që mbeten pa shkollë për një gërmë gabim në gjeneralitetet e tyre dhe të prindërve të tyre. I kam dhënë prioritet atyre qytetarëve që për vite me radhë nuk marrin asnjë informacion apo marrin informacion të gabuar nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. I kam dhënë prioritet atyre qytetarëve që pas 12 vjetësh, agjencitë e legalizimeve ose nuk i kanë kthyer fare përgjigje qytetarit ose i përjashtojnë nga legalizimi pa asnjë shkak ligjor. I kam dhënë prioritet qytetarëve të shpronësuar që u është vlerësuar shtëpia me gjithë truall për të bërë rrugë biçikletash në vlerën e një koteci modern pulash. I kam dhënë prioritet vendimeve kundër organeve shtetërore që dërgojnë ekskavatorët për prishje objekti pa paraqitur qytetarit një shkak të ligjshëm. I kam dhënë prioritet qytetarëve që janë pa një këmbë apo pa një dorë dhe që janë përjashtuar nga pensioni i invaliditetit. Këto provohen me vendimet që kam unë me vonesë, ku një pjesë e tyre janë pushime gjykimi, kthim padie për të meta, pa përjashtuar edhe ato që kanë ankim. Pra normalisht unë kam bërë një përzgjedhje, mos të them që s'i kam përzgjedhur, por ka njerëz që vijnë tek kryesekretaria dhe nuk ikin pa marrë vendimin. Unë jam i detyruar të lë edhe gjyqin, ta shtyjë, vetëm t'i bëjë vendimin. Se edhe qytetarët, dihen, në organet shtetërore nuk gjejnë të drejtën sepse për çdo gjë i thonë, -“shkoni në gjykatë!”

Më vjen shumë keq që thotë ministrja e Drejtësisë bashkë me Kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që këto janë veprime që diskreditojnë figurën e gjyqtarit.

Unë nuk mund ta pranoj kurrsesi dhe përbuz me neveri këtë epitet. Shkoj në punë në orën 07:⁰⁰ dhe dal në orën 08:⁰⁰ të darkës. Dhe nuk mund të më thuhet mua ‘i diskredituar’. Të diskredituar janë ata vartës të ministres së Drejtësisë që kanë 20 vjet që nuk u kanë kthyer përgjigje qytetarëve.

Ilir Meta: Ju lutem, nuk kemi ardhur këtu për të bërë akuza reciproke. Ju do përgjigjeni për pretendimet që ka ministria dhe Inspektorati ndaj jush.

Ken Dhima: Ka edhe një akuzë ministria, që s'e përmendi.

Me një korrespondencë time me Kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kam thënë që, një prej shkaqeve të vonesës është edhe vetingu, bërja e dokumentave, etj., etj. E kam quajtur 'vetingu Sorosian'. Dhe ministrja më thotë mua që ti s'ke të drejtë të mendosh. Por edhe Marksia thoshte, -"mendimet s'kanë doganë". Sorosi është një rrjetë e zezë që ka pushtuar Evropën dhe Shqipërinë dhe reforma në drejtësi...

Ilir Meta: Ç'lidhje ka tani? Bëjmë politikë këtu?

Ken Dhima: Po sepse... Jo! Është tek relacioni. S'ka për politikë. Unë kam mendimin tim si gjyqtar. Edhe për Sorosin, çfarë lidhje ka kjo këtu?

Këto janë domethënë pikat që unë e kam edhe në observacion, e kam edhe në... 220 ditë janë ditët e punës dhe nuk e kuptoj se si mundet një gjyqtar të arsyetojë 8 vendime themeli?! Unë nuk bëj pica.

Ilir Meta: Atëherë, pretendimi juaj kryesor është që keni pasur një mbingarkesë shumë të madhe për të bërë çdo gjë. Dakord!

Ken Dhima: Edhe diçka për të shtuar.

Nga presioni që më ka bërë Kryeinspektorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që mi dërgonte çdo muaj inspektorët, çfarë kam bërë tani? Tani, në qoftë se unë i mbaroja për 2 muaj gjyqet, unë tani i përfundoj 4-9 muaj. Për shkurt, mars, prill nuk kam asnjë dosje me vonesë. Unë kam këtu, kam dorëzuar 600 dosje këtë vit. Me short më kanë rënë 400 për 4 muaj. Ja ku janë dosjet e dorëzuara, por ama qytetarit i kam zvarritur gjykimin, që unë mos të kem dosje me vonesë e të mos dalë këtu e të më thotë ministri 'i diskredituar'. Urdhëroni! Kaq kisha!

Ilir Meta: Dakord!

Keni ndonjë pyetje?

Ken Dhima: Unë këtu kam të gjitha provat. Kryesekretaria.

Gjin Gjoni: Ta lejmë pjesën e politikës, të kalojmë tek pjesa profesionale.

Sa çështje ke përfunduar në vitin 2015-2016 Ken?

Ken Dhima: Atëherë, në vitin 2015, 852 vendime themeli. Gjithsej janë 954.

Gjin Gjoni: 954.

Po në 2016?

Ken Dhima: Por pa llogaritur ato qindra vendime pranim ankimi dhe rekurse.

Po mirë, ato unë i bëj, se kush mi bën.

Nuk kam pasur as këshilltare ligjore. Se këshilltarja ime ligjore më shumë s'vinte sesa vinte. Ky ishte problemi i kryetarit të gjykatës. Por nuk ka problem. Sepse ai më padit mua shumë kollaj. Unë s'jam mësuar të padis, por ja që duhen thënë tani.

Për 2016, 1013

Është bërë gjyqtari tabelë qitjeje. Ne nuk mundet vetëm të goditemi.

Gjin Gjoni: Duhet edhe të mbrohesh.

Po, mbrohu pra.

Ken Dhima: Se ne jemi njerëz. Kemi familje. Kemi njerëz. Kemi miq. Kemi...

Gjin Gjoni: Për 2016 të lutem.

Ken Dhima: Kemi jetë private.

Sipas ministres, unë duhet të ngordh në punë.

Në vitin... Çfarë viti?

2016-ën, 1013.

Gjin Gjoni: Okej!

Po çështje në dorë, sa ke pas? Përveç vendimeve.

Ken Dhima: Këtë radhë kam rënë. Duhet të kem nja 150. Për arsytim nuk kam. Se i përfundova. Mund të jenë nja 30 copë.

Gjin Gjoni: Faleminderit!

Ilir Meta: Pyetje tjetër s'keni?

Mirë, ju falenderojmë!

Ken Dhima: Faleminderit juve!

(Gjyqtari Ken Dhima largohet nga salla e mbledhjes.)

Gerd Hoxha: Okej! Është bërë ndonjë studim bazuar në praktikat e SEPEZH-it e në vendet e rajonit, cila është ngarkesa që mund të përballojë një gjyqtar; sa vendime mund të arsyetojë ai në ditë dhe, a është bërë ndonjë krahasim me këto vendet rreth e

rrotull? Ka ndonjë studim krahasimor të tillë? Sepse e kemi hasur gjithmonë këtë problem.

Etilda Gjonaj: E mora kërkesën zoti Hoxha. Herës tjetër do t'ju jap një përgjigje të saktë sa çështje ka një gjyqtar krahasuar me të gjitha vendet e rajonit dhe vendet e Bashkimit Evropian. Dhe kjo është arsyeja që u ndërmor reforma në drejtësi, për të ndryshuar sistemin, për të ulur ngarkesën e gjyqtarëve, për të centralizuar gjykatat, për t'i bërë më të mëdha, me numër gjyqtarësh më të lartë, që të ulet edhe ngarkesa e gjyqtarëve dhe të japin drejtësinë sa më efiçente.

(Zoti Hoxha flet pa ndezur mikrofonin.)

Atë do ta vendosi KLGJ-ja e re kur të ngrihet, pasi të bëjë studimin, të vendosi hartën e re gjyqësore.

Gerd Hoxha: Atëherë, zoti President, nisur nga... për mua kjo është thelbësore, kjo gjë që tha ministrja, që edhe ne, jo vetëm unë, por të gjithë anëtarët e KLD-së, por edhe opinionin publik, të ketë një perceptim të saktë sa duhet të shqyrtojë një gjyqtar dhe se cila është edhe mundësia fizike dhe objektive, se sa mund të shkruajë një gjyqtar në ditë. Se ato janë vendime. Them ta shtyjmë vendimmarrjen, pasi të na vijë edhe përgjigja e ministres, meqë e mori shënim. Bëri shumë mirë që e mori shënim që ta ketë parasysh. Radhës tjetër të ngarkojë atë stafin e saj të na japë përgjigje dhe vendosim radhës tjetër.

Gjin Gjoni: Është e vërtetë zoti President që ka një vonesë dhe po t'i marrësh sot gjyqtarët e gjykatave administrative, jo vetëm zoti Ken Dhima, por të gjithë gjyqtarët e gjykatave administrative janë tej afateve që parashikon ligji, për shkak të ngarkesës.

Të themi të drejtën, të bësh 1033 çështje brenda 1 viti, është një ngarkesë e cila është e papërbalueshme dhe po t'i referohesh statistikave të SEPEZH-it të cilat japin ngarkesën në vendet e Bashkimit Evropian dhe njëkohësisht në vendet e tjera, janë 220 dosje ngarkesa e një gjyqtari, aq më tepër që, edhe me vendim të KLD-së, sistemi i vlerësimit është i ndërtuar mbi bazën e 220 dosjeve të cilat duhet të ketë në gjykim në vit. 200 e ca dosje.

Kështu që, në rastin konkret, unë them që po t'i marrësh edhe sot, jo në mënyrë selektive, por po t'i marrësh të gjithë gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë administrative, por ke edhe gjyqtarë të gjykatave të apeleve që dorëzojnë jashtë 3-4

muajve. Që s'kanë ngarkesën e tyre. Raportimet çohen periodikisht në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe kanë çështje të cilat mund të kenë çerekun e ngarkesës së tyre.

Etilda Gjonaj: Hajde t'i themi, se s'besoj se është vetëm ky gjyqtar me ngarkesën maksimale. Besoj që janë një numër i caktuar gjyqtarësh. Hajde t'i themi Inspektoratit të mos kryejë më inspektime për ngarkesën dhe po ia bëjmë nul të gjithë veprimtarinë inspektuese që kryen. Tashti, kjo është pra.

Ilir Meta: A ka mundësi të bëj një ndërhyrje?

Marsida Xhaferllari: Përgjatë periudhës së 1 viti, këto hetime disiplinore i kemi bërë bazuar në raportimin e kryetarit të gjykatës, që është një mekanizëm që bëhet muaj për muaj.

(Zoti President flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Meta: Po në raport me të gjithë çështjet që...

Marsida Xhaferllari: Në momentin që kemi sugjeruar procedimin disiplinor të rastit në fjalë, sigurisht që edhe ngarkesën e kemi mbajtur në konsideratë, por na kanë tërhequr vëmendjen disa karakteristika. Së pari, që në këtë gjykatë është i vetmi gjyqtar që raportohet me këto lloj vonesash, megjithëse në gjykatë janë tre gjyqtarë. Kanë ngarkesë pothuajse të barabartë. Nuk po them domethënë që ngarkesa mbi rastin në fjalë, ngarkesa në Gjykatën Administrative të Vlorës dhe tek të gjitha gjykatat është mbi normalen. Pa diskutim. Megjithatë ka një diferencë në performancën e këtij gjyqtari, në raport me dy gjyqtarët e tjerë. Sikundër e pranoi edhe ai vetë që, besoj e ka pas fjalën 'presion' pozitiv, që tha që tani nuk ka më vonesa, që më është bërë presion, e para. E dyta, ka qenë sasia e vonesës. Na kanë tërhequr vëmendjen që kanë qenë vonesa disamujore, 3 muaj deri në 5 muaj. Një pjesë e këtyre çështjeve kanë qenë edhe çështje të lehta (urdhura ekzekutimi apo marrëdhënie pune apo korrigjim i akteve të gjendjes civile). Megjithatë, e përsërisim edhe një herë që, ngarkesa sasiore që gjyqtari pretendon është e vërtetë. Është reale.

Gerd Hoxha: Edhe diçka tjetër. Edhe një herë, të më kuptoni.

Unë nuk po përliq vonesat. Unë jam vet gjyqtar. Edhe unë kam çështje me vonesë. Po them, të vijë të më inspektojë edhe nesër Inspektorati. Edhe unë kam.

Le të vijë. Se s'kam frikë unë. Vetëm Zotit i jap llogari lart. Problemi është që, doja të dija edhe këtë...

(Zoti President flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Meta: Temperamenti i tij ishte tërësisht i papërmbajtur dhe i pajustificuar. Ndoshta gjykimi mund të jetë i njëanshëm. Mund të jetë...

Gerd Hoxha: Është çështje tjetër.

Ilir Meta: Ka rëndësi.

Gerd Hoxha: nuk i heq asnjë presje asaj. Edhe unë jam vërtet i tronditur nga mënyra se si u soll ai njeri. Unë e njoh prej vitesh atë njeri për arsye të tjera, që nuk ma afektojnë vendimmarrjen sot. Nuk pajtohem aspak me mënyrën se si flet ai. Por nuk e kemi marrë këtu për sjelljen. Në qoftë se është për sjelljen, bëjmë një procedim tjetër. Dhe doja të dija edhe diçka. Përveç edhe vonesës, çfarë pasoja janë shkaktuar? Ta kem edhe këtë. Janë shkaktuar pasoja nga vonesa? Sepse ligji thotë, shkaktohen vonesa që sjellin pasoja të rënda në të drejtat e shtetasve apo të shtetasit. Janë identifikuar edhe këto pasoja?

E drejta për një proces të rregullt është... Ne në Gjykatën e Lartë kemi 23 mijë dosje me vonesë.

Ilir Meta: Dakord! Të shprehemi për pjesën...

Gjin Gjoni: Kundër.

Vangjel Kosta: Pro.

Brunilda Kadi: Kundër.

Petrit Çomo: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Neritan Cena: Kundër.

Gerd Hoxha: Kundër dhe ta shpjegoj votën kundër.

Eci me prezumimin e pafajësisë. Në kushtet kur nuk mu bë e mundur një lloj studimi krahasimor lidhur me ngarkesën e punës së gjyqtarëve dhe sa është mundësia objektive që mund të gjykojë një njeri, sa mund të shkruajë, duke marrë ditët e vitit, unë atëherë votoj kundër.

Ilir Meta: Dakord! Atëherë mbyllet mbledhja.

U shty pika 4, u tha më përpara.

Vazhdojmë punët të gjithë.

Mirupafshim.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë